



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 32

Tiranë – E premte, 15 mars 2019

## PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 25, datë 16.1.2019	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit për vitin 2019, për pagesën e Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve (ICSID).....	1409
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 6.3.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, të ndryshuar.....	1409
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 6.3.2019	Për një ndryshim në vendimin nr. 590, datë 18.10.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Ujit” .....	1411
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 6.3.2019	Për vendosjen e standardeve në kryerjen e disa aktiviteteve me punonjës të përkohshëm, në njësitë e qeverisjes qendrore.....	1411
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 110, datë 6.3.2019	Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre.....	1412
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 111, datë 6.3.2019	Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës.....	1416
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 113, datë 6.3.2019	Për emërimin e anëtarëve që përfaqësojnë palën shqiptare në Komisionin Shqiptaro-Malazez për Menaxhimin e Ujërave me interes të përbashkët...	1423

Udhëzim i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 6.3.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 4, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”.....	1424
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 6, datë 25.2.2019	Për funksionet, autoritetin dhe përgjegjësitë e Avokatit të Tatimpaguesve, procedurat që do të zbatohen prej tij në mbrojtje të interesave të tatimpaguesve, si dhe procedurat që duhet të ndiqen nga tatimpaguesit, për të përfituar mbrojtjen e të drejtave të tyre nga Avokati i Tatimpaguesve.....	1424
Vendim i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.3.2019	Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.....	1435
	Vendim ( <i>i shkurtuar</i> ) për shpalljen të vdekur të shtetasit Ermal Xhelo...	1445



## VENDIM

Nr. 25, datë 16.1.2019

**PËR NJË SHITESË FONDI NË  
BUXHETIN E VITIT 2019, MIRATUAR  
PËR MINISTRINË E TURIZMIT DHE  
MJEDISIT, NGA FONDI REZERVË I  
BUXHETIT TË SHTETIT PËR VITIN  
2019, PËR PAGESËN E QENDRËS  
NDËRKOMBËTARE PËR ZGJIDHJEN E  
MOSMARRËVESHJEVE TË  
INVESTIMEVE (ICSID)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave,

## VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në buxhetin e miratuar për vitin 2019, i shtohet fondi prej 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekësh, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2019, si pagesë për detyrimet që rrjedhin ndaj Qendrës Ndërkombëtare për zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve (ICSID), lidhur me arbitrazhin ndërkombëtar ARB/14/26, ndërmjet shoqërisë “Albaniabeg Ambient” sh.p.k., Angelo Novelli, “*Construzioni*”, s.r.l., kundër Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI  
Edi Rama**

## VENDIM

Nr. 107, datë 6.3.2019

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME  
NË VENDIMIN NR. 187, DATË 8.3.2017,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR  
MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË  
NIVELEVE TË PAGAVE TË  
NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE,  
ZËVENDËSMINISTRIT DHE  
NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË  
KRYEMINISTRI, APARATET E  
MINISTRIVE TË LINJËS,  
ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT,  
KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, GJYKATËN E LARTË,  
PROKURORINË E PËRGJITHSHME,  
DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA,  
INSTITUCIONET NË VARËSI TË  
KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË  
VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS  
DHE ADMINISTRATËN E  
PREFEKTIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave,

## VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 1/2:

i) shtohen emërtesat “Qendra e Botimeve për Diasporën” dhe “Avokatura e Shtetit”;

ii) emërtesa “Komiteti Shtetëror i Minoriteteve” zëvendësohet me “Komiteti për Pakicat Kombëtare”.

b) Në shkronjën “a”, të pikës 1/3, emërtesat “Avokatura e Shtetit” dhe “Sekretariati Kombëtar i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI - Shqipëri)”, shfuqizohen;



c) Në shkronjën “b”, të pikës 1/3:

i) emërtesa “Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit” zëvendësohet me “Agjencia Kombëtare e Falimentimit”;

ii) emërtesa “Komisioni Shtetëror i Ndhmës Juridike” zëvendësohet me “Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas”;

iii) shtohet emërtesa “Sekretariati Kombëtar i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI - Shqipëri)”;

iv) emërtesa “Shtëpia Botuese e Librit Universitar” shfuqizohet.

ç) Në shkronjën “c”, të pikës 1/3:

i) emërtesat “Qendra e Realizimit të Veprave të Artit” dhe “Klubi Shumësportësh Partizani” shfuqizohen;

ii) shtohet emërtesa “Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit”.

d) Në lidhjen nr. 2, që përmendet në pikën 2/“a”, në rreshtin e parë të kolonës së dytë, pas emërtimit “Master i Arteve” shtohet “Master profesional të përfutuar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike”.

dh) Në lidhjen 3, që përmendet në pikën 3, shtohet, si më poshtë vijon:

Komisioneri i Mbrojtjes nga Diskriminimi	Inspektor	III-a
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Koordinator në Sekretariatit (Drejtorinë e Përgjithshme) e BE-së	III-a

e) Pika 4/14 shfuqizohet.

ë) Në pikën 6:

i) pas paragrafit “Zëvendësministër” shtohet paragrafi “- Kryetar i Komitetit për Pakicat Kombëtare - 153 300 lekë”;

ii) paragrafët e Prefektit të Qarkut Tiranë, prefektëve të qarqeve të tjera dhe nënprefektëve ndryshohen, si më poshtë vijon:

“- Prefekt 153 300 lekë;

- Nënprefekt 123 000 lekë.”.

f) Pas pikës 8/9 shtohet pika 8/10, me këtë përmbajtje:

“8/10. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës në administratën e Avokaturës së Shtetit janë

sipas lidhjes nr. 5/10, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Nëpunësit e Avokaturës së Shtetit, të cilët deri në datën 10.2.2012 përfitonin një pagë më të lartë sesa parashikohet në lidhjen nr. 5/10, do të vazhdojnë të përfitojnë pagën e mëparshme. Nëpunësit e tjerë përfitojnë pagat sipas përcaktimit në lidhjen nr. 5/10.

Nëpunësi i emëruar jashtë vendit, në pozicionin “Jurist pranë Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë në Këshillin e Evropës, i cili është përfaqësues i përhershëm pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”, ka statusin financiar të përfaqësuesit të ministrisë së linjës në përfaqësinë tonë diplomatike pranë BE-së.”.

g) Paragrafi i dytë i pikës 9 shfuqizohet.

gj) Në lidhjen nr. 6/6, që përmendet në pikën 9/6, pas emërtesës “Inspektor auditit” shtohen emërtesat “Këshilltar në kabinetin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-ve” dhe “Shef zyre në zyrën e zëvendës-shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-ve”.

h) Pika 9/9 dhe lidhja 6/9 shfuqizohen.

i) Në pikën 10 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Nëpunësit e Sekretariatit Kombëtar të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI - Shqipëri), të cilët sipas organizimit të mëparshëm kanë pasur emërtesën “koordinator” dhe një nivel page më të lartë se përcaktimi i këtij vendimi, do të vazhdojnë të përfitojnë pagën që kanë pasur sipas organizimit të mëparshëm.”.

j) Pas pikës 14 shtohet pika 14/1, me këtë përmbajtje:

“14/1. Punonjësit në projektet me tituj “Projekte me KfW”, “Projekti i kanalizimeve të Tiranës së Madhe”, “Projekti i shërbimeve esenciale”, në Agjencinë Kombëtare të Ujësllës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, deri në përfundimin e projektit përkatës të trajtohen me pagë:

- drejtues projekti (koordinator) - kategoria II-a;
- specialist - kategoria III-b.

Punonjësit në projektet e programeve IPA në Agjencinë Kombëtare të Ujësllës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, deri në fund të vitit 2019, të trajtohen me pagë, si më poshtë vijon:



- drejtues projekti (koordinator) - kategoria II-a;
- specialistët - kategoria III-b.

Për vitin 2020 e në vijim, punonjësit e projekteve të programeve IPA në Agjencinë Kombëtare të Ujësjetës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve të trajtohen me pagë njësoj si nëpunësit e tjerë të kësaj agjencie.”

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2019, të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion dhe;

a) për prefektët dhe nënprefektët, të fillojnë nga data 1 janar 2019;

b) për përcaktimin në shkronjën “d” të fillojnë nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

c) për të gjitha parashikimet e tjera të fillojnë nga momenti i transferimit apo emërimit të nëpunësve në pozicionet e reja, pas miratimit të strukturave dhe organikave përkatëse.

3. Pika 19/1, e vendimit nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
**Erion Braçe**

Lidhja nr. 5/10

#### Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës në administratën e Avokaturës së Shtetit

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT
Jurist	III-b	1 ose 2
Specialist	IV-a	1, ose 2, ose 3
Sekretar	IV-b	1, ose 2, ose 3

#### VENDIM Nr. 108, datë 6.3.2019

#### PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 590, DATË 18.10.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRBËRJEN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave,

#### VENDOSI:

Në pikën 1, të vendimit nr. 590, datë 18.10.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Ujit”, fjalët “Ministrin e Brendshëm” zëvendësohen me “Ministrin e Mbrojtjes”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
**Erion Braçe**

#### VENDIM Nr. 109, datë 6.3.2019

#### PËR VENDOSJEN E STANDARDEVE NË KRYERJEN E DISA AKTIVITETEVE ME PUNONJËS TË PËRKOHSHËM, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave,

#### VENDOSI:

1. Aktivitetet që nuk mund të realizohen nga punonjësit organikë, në kuadër të veprimtarisë së tyre vjetore në njësitë e qeverisjes qendrore, konsiderohen si shërbime dhe realizohen me sipërmarrje (nëpërmjet të tretëve), duke zbatuar legjislacionin në fuqi për prokurimin. Në rastet kur



nuk mund të realizohen me sipërmarrje dhe/ose sipërmarrja ka kosto më të lartë, këto aktivitete realizohen nëpërmjet marrjes së punonjësve me kontratë të përkohshme.

2. Për efekt të këtij vendimi, aktivitet në fushën e konsulencës, ekspertizës, inspektimit, auditimit, këshillimit, sigurisë fizike dhe teknologjisë së informacionit nuk realizohen nëpërmjet marrjes së punonjësve me kontratë të përkohshme. Shërbimi i ofruar prej tyre i nënshtrohet procedurave përkatëse të prokurimit publik apo akteve të veçanta ligjore në fuqi.

3. Punonjës me kontratë të përkohshme pune, në njësitë e qeverisjes qendrore, konsiderohen punonjësit e kontraktuar jashtë organikës së njësisë, të cilët realizojnë:

a) një aktivitet që realizohet në një periudhë kohore jo më shumë se 6 muaj;

b) një aktivitet që, pavarësisht se mund të shtrihet gjatë gjithë vitit ushtrimor, nuk zgjat më shumë se 6 orë në ditë;

c) një aktivitet që realizon të ardhura dytësore, përdorimi i të cilave parashikohet në ligjin vjetor të buxhetit, për këtë qëllim.

4. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për çdo ministri dhe institucion, miratohet çdo vit nga Këshilli i Ministrave. Në këtë numër nuk përfshihen kategoritë e punonjësve, si më poshtë vijon:

a) instruktorët e qendrave/shkollave të formimit profesional;

b) punonjësit e anketave statistikore;

c) punonjësit e kontraktuar në proceset zgjedhore/ paszgjedhore;

ç) pedagogët e jashtëm/trajnerë të angazhuar në formimin profesional të magistratëve;

d) Punonjësit e Qendrave të Transferimit të Teknologjisë së Informacionit, të Agjencisë Kombëtare të Duhan-Cigareve dhe Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve.

Rregullat për marrjen e këtyre punonjësve, afatet kohore dhe të tjera specifitime për kontraktimin me kohë të pjesshme të tyre bëhen sipas udhëzimit të përbashkët të institucionit qendror përgjegjës dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

5. Kërkesa për punonjës me kontratë të përkohshme bëhet vetëm kur institucioni disponon fondet e nevojshme financiare për mbulimin e shpenzimeve të këtyre punonjësve dhe, si rregull,

kjo kërkesë paraqitet pas miratimit të ligjit të buxhetit të vitit pasardhës kalendarik. Kërkesa paraqitet pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e argumentuar dhe e shoqëruar me informacion të detajuar mbi numrin e punonjësve, pozicionin e punës dhe afatin kohor të kontraktimit. Pas shqyrtimit të kërkesave të paraqitura, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i dërgon për miratim në Këshillin e Ministrave.

6. Punonjësi me kontratë të përkohshme merren në punë në përputhje me kriteret e parashikuara për atë vend pune.

7. Paga e punonjësit me kontratë të përkohshme përcaktohet në referencë të vendimit përkatës Këshillit të Ministrave, për pozicionin për të cilin ai kontraktohet. Për pozicionin “specialist”, paga e punonjësit me kontratë të përkohshme përcaktohet referuar kategorisë më të ulët të pagës së këtij pozicioni, në institucionin në të cilin ai kontraktohet.

8. Vendimi nr. 1703, datë 24.12.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe të veprimtarive sezonale/të përkohshme, për ministrinë dhe institucionet buxhetore”, shfuqizohet.

9. Ngarkohen të gjitha ministrinë dhe institucionet qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

**Erion Braçe**

## VENDIM

**Nr. 110, datë 6.3.2019**

### **PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE TË RREGULLAVE TË PËRZGJEDHJES SË ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE, TË AUTORIZUARA PËR OFRIMIN E NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE TË GARANTUAR NGA SHTETI, QË PËRFITOJNË FINANCIME NGA BUXHETI I SHTETIT DHE MËNYRA E FINANCIMIT TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave,



## VENDOSI:

1. Organizatat jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti (në vijim “organizata jofitimprurëse të autorizuar”) përfitojnë financime nga buxheti i shtetit, pas një procesi konkurrues dhe transparent përzgjedhjeje, bazuar në procedurat dhe rregullat e përcaktuara në këtë vendim.

2. Procedurat e përfitimit të financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuar bëhen duke u bazuar në parimet e mëposhtme:

a) konkurrueshmërisë;

b) trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuar, aplikuese për përfitimin e financimit;

c) transparencës të të gjitha fazave që lidhen me shqyrtimin, vendimmarrjen dhe përzgjedhjen e organizatave jofitimprurëse të autorizuar;

ç) kriterëve të mirëpërcaktuara dhe publike, të cilat do të mundësojnë vlerësimin e propozimeve të organizatave jofitimprurëse të autorizuar në raport me objektivat dhe prioritetet e mbështetjes financiare;

d) efektivitetit dhe ekonomizimit në shfrytëzimin e fondeve publike, duke siguruar që të arrihen objektivat dhe prioritetet e përcaktuara me një kosto sa më të favorshme për realizimin e shërbimit të synuar;

dh) respektimit të plotë të parimeve të llogaridhënies dhe raportimit në përdorimet e fondeve publike;

e) financimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore për kategoritë e përfituesve që janë me prioritet për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas dhe në interes të përfituesve të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti;

ë) ruajtjes së pavarësisë së organizatës jofitimprurëse të autorizuar;

f) parandalimit të konfliktit të interesit, si dhe të çdo aktiviteti tjetër që rrezikon ofrimin me integritet të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

3. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas planifikon në buxhetin e saj një zë të veçantë për financimin e organizatave jofitimprurëse të autorizuar dhe harton, në bazë të shumës së miratuar, planin vjetor të financimit.

4. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, brenda 1 muaji nga miratimi i buxhetit, bën publike në faqen

zyrtare të saj planin vjetor të financimit që përmban:

a) shumën e përfitimit financiar për vitin fiskal;

b) objektivat e përfitimit financiar, sipas nevojave të identifikuar;

c) numrin e përfaqësuesve të organizatave jofitimprurëse të autorizuar që mund të përfaqësohen në procesin e përzgjedhjes;

ç) kohën e hapjes së thirrjes për aplikime; dhe

d) kohën e fillimit të zbatimit të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti.

5. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas njofton, në faqen zyrtare të institucionit dhe pranë Buletinit të Njoftimeve Zyrtare, çdo fillim viti kalendarik, thirrje të përgjithshme ose gjatë vitit, në raste të veçanta ose të paparashikuara, për përmbushjen e nevojave të kategorive të caktuara të popullsisë për ndihmë juridike parësore, duke caktuar:

a) shumën e fondeve financiare në dispozicion;

b) numrin e organizatave jofitimprurëse të autorizuar që mund të përfitojnë financimin e caktuar;

c) kriteret e përgjithshme dhe të veçanta që duhet të plotësojnë organizatat jofitimprurëse të autorizuar;

ç) listën e dokumenteve të nevojshme për t'u paraqitur;

d) afatin e përfundimit të thirrjes;

dh) të dhëna për mënyrën e dorëzimit të aplikimeve;

e) udhëzime të tjera të nevojshme për plotësimin e aplikimit, të cilat përcaktohen me urdhër të drejtorit të Ndihmës Juridike Falas dhe që publikohet së bashku me thirrjen.

6. Për t'u kualifikuar për të përfituar financime, organizatat jofitimprurëse të autorizuar duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, si më poshtë vijon:

a) Kriteret e përgjithshme:

i) të kenë marrë autorizimin nga ministri i Drejtësisë për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti;

ii) të mos kenë dy burime të njëjta financimi për të njëjtin aktivitet;

iii) të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi që cenon zhvillimin e drejtë të procesit të përzgjedhjes me drejtorin e Ndihmës Juridike Falas.

b) Kriteret e veçanta:



i) projektpropozimin, i cili përmban të dhënat teknike-financiare për ofrimin e shërbimit, qëllimin, objektivat specifikë, aktivitetet, kalendarin e realizimit, rezultatet e synuara, përfituesit e drejtpërdrejtë;

ii) të dhëna për personelin, duke specifikuar detyrat dhe siguruar jetëshkrimin e tyre;

iii) të dëshmojnë se kanë përvojë në realizimin e shërbimeve të ngjashme, duke siguruar dokumente dhe të dhëna të realizimit të shërbimeve të ngjashme në të kaluarën, nëse kjo është e domosdoshme, sipas thirrjes përkatëse;

iv) kërkesa të tjera specifike që mund të jenë të nevojshme për ofrimin e ndihmës juridike parësore, sipas thirrjes publike të veçantë.

7. Dokumentacioni për vërtetimin e plotësisë të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta depozitohet pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Organizata jofitimprurëse e autorizuar duhet të dëshmojë se i plotëson kriteret e veçanta duke dorëzuar dokumentet përkatëse sipas pikës 6, të këtij vendimi, dhe thirrjes publike. Në rast të mosplotësisë të një prej kriterëve të veçanta, aplikimi konsiderohet i paplotë dhe, si i tillë, nuk kualifikohet për përfitimin financiar.

8. Pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas ngrihet dhe funksionon, me kohë të pjesshme:

a) komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve për financim të organizatave jofitimprurëse të autorizuar;

b) komisioni i ankimit për shqyrtimin e ankesave për shkelje të qëllimshme të procedurës së shqyrtimit, të vendimeve për përzgjedhjen e organizatave jofitimprurëse të autorizuar që përfitojnë financim, si edhe të masës së financimit.

9. Komisioni vlerësues përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë vijon:

a) 2 (dy) përfaqësues nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, që mbulojnë çështjet juridike;

b) 1 (një) përfaqësues nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, që mbulon çështjet e financës dhe buxhetit;

c) (një) përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, që mbulon çështjet e të miturve;

ç) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, që mbulon çështjet e financës dhe të buxhetit.

10. Komisioni i ankimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, prej të cilëve 1 (një) përfaqësues nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe 2 (dy) përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë. Në

komisionin e ankimit nuk mund të marrin pjesë anëtarët të cilët kanë marrë pjesë në shqyrtimin e aplikimeve, në kuadër të komisionit vlerësues.

11. Komisioni vlerësues dhe komisioni i ankimit krijohen gjatë kohës që thirrja publike për aplikim është e hapur dhe emrat e anëtarëve nuk bëhen publikë deri para shpalljes së rezultateve të shqyrtimit të ankesave. Në komisione nuk mund të marrin pjesë subjekte që gëzojnë statusin e funksionarit politik.

12. Për të siguruar nevojat administrative dhe mbështetjen organizative për veprimtarinë e komisionit vlerësues dhe të komisionit të ankimit, me urdhër të drejtorit të Ndihmës Juridike Falas, ngrihet sekretariati teknik, i përbërë nga përfaqësues të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

13. Rregulla më të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e komisionit vlerësues dhe komisionit të ankimit përcaktohen në rregulloren e brendshme të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, që miratohet me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

14. Komisioni vlerësues shqyrton aplikimet dhe vlerëson përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta, si dhe cakton masën financiare përfituese brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e mbylljes së thirrjes publike.

15. Rezultatet e verifikimit publikohen në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, brenda 3 (tri) ditëve nga dita e përfundimit të procesit të shqyrtimit.

16. Vendimi i komisionit vlerësues mund të ankimohet pranë komisionit të ankimit, brenda 5 (pesë) ditëve nga njoftimi i rezultateve për shkelje të procedurave, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

17. Ankesa shqyrtohet nga komisioni i ankimeve, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes.

18. Komisioni i ankimit nxjerr vendim të arsyetuar për pranimin ose mospranimin e ankesës. Vendimi i arsyetuar i komisionit të ankimit i njoftohet organizatës jofitimprurëse të autorizuar që ka bërë ankimin, jo më vonë se 2 (dy) ditë nga marrja e vendimit dhe publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në gjykatën administrative kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.





19. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas lidh kontratën e shërbimit të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore me organizatën jofitimprurëse të autorizuar të përzgjedhur, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i procesit të përzgjedhjes.

20. Kontrata e shërbimit lidhet për një periudhë 1 (një)-vjeçare dhe përmban:

a) të dhëna lidhur me vlerën e financimit të përfituar;

b) shtrirjen territoriale të shërbimit të ofruar të ndihmës juridike parësore;

c) target-grupet e përfituesve të ndihmës juridike të synuar;

ç) mënyrën dhe mekanizmat e monitorimit të zbatimit të kontratës së shërbimit;

d) përcaktime të qarta lidhur me:

i) qëllimin e përfitimit financiar dhe ndalimin e përdorimit të vlerës së përfituar për qëllime të tjera jashtë kontekstit të ndihmës juridike parësore;

ii) mënyrën e kryerjes së pagesës dhe të transaksioneve financiare nëpërmjet institucioneve bankare, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi;

iii) shmangien e konfliktit të interesit gjatë përdorimit të masës financiare të përfituar.

dh) rastet kur kontrata e shërbimit mund të zgjidhet para përfundimit të saj;

e) mënyrën e kthimit të vlerës financiare në rast të ndërprerjes së kontratës së shërbimit për shkaqe që lidhen me mospërbushjen e detyrimeve nga organizata jofitimprurëse e autorizuar.

21. Çdo organizatë jofitimprurëse e autorizuar e përzgjedhur nuk mund të përfitojë më shumë se 20% të buxhetit të planifikuar për financimin e dhënies së ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti nga organizatat jofitimprurëse.

22. Organizata jofitimprurëse e autorizuar, përfituese e financimit, raporton pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas periodikisht çdo 3 (tre) muaj mbi përdorimin e fondeve të financuara dhe përbushjen e detyrimeve të përcaktuara në kontratën e shërbimit.

23. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas kryen mbikëqyrje nëpërmjet vizitës në terren të paktën 1 (një) herë në vit gjatë kohëzgjatjes së kontratës së shërbimit për të verifikuar standardet e shërbimit të ofruar nga organizata jofitimprurëse e autorizuar, përfituese e financimit.

24. Në rast të konstatimit të shkeljes së kontratës së shërbimit nga organizata jofitimprurëse e autorizuar përfituese e financimit, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas verifikon rastin dhe merr masa në raport me shkeljen e kryer, duke urdhëruar deri në zgjidhjen e parakohshme të kontratës së shërbimit dhe revokimin e autorizimit nga ministri i Drejtësisë.

25. Në përfundim të zbatimit të kontratës së shërbimit për ofrimin e ndihmës juridike parësore, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas harton raportin e monitorimit të përdorimit të fondeve nga organizata jofitimprurëse gjatë periudhës 1-vjeçare. Raporti i monitorimit i përcillet ministrit të Drejtësisë dhe përmban:

a) të dhënat e organizatës jofitimprurëse të autorizuar që ka përfituar financim;

b) masën financiare të përfituar;

c) mënyrën e alokimit të masës financiare të përfituar;

ç) kohëzgjatjen dhe statusin e zbatimit të kontratës së shërbimit;

d) shërbimet e ndihmës juridike parësore të ofruara;

dh) numrin dhe kategorinë e përfituesve të shërbimeve të ofruara;

e) shtirjen gjeografike/territoriale të shërbimeve të ofruara;

ë) rezultatet e arritura përmes shërbimeve të ofruara;

f) ndikimet në përmirësimin e trajtimit të përfituesve nga ndihma juridike parësore e ofruar.

Formati i raportit të monitorimit miratohet me urdhër të drejtorit të Ndhmës Juridike Falas.

26. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
**Erion Braçe**

**VENDIM****Nr. 111, datë 6.3.2019****PËR PROCEDURAT DHE RREGULLAT  
PËR KTHIMIN E RIATDHESIMIN  
E FËMIJËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 11, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave,

**VENDOSI:****I. Rregulla të përgjithshme**

1. Ky vendim ka për objekt të përcaktojë procedurat dhe rregullat e detajuara mbi procesin:

a) e kthimit të fëmijëve të pashoqëruar, të huaj apo pa shtetësi, që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, përfshirë fëmijët e pashoqëruar, në zbatim të marrëveshjes së ripranimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian apo marrëveshjeve të tjera të ripranimit, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) e riatdhesimit të fëmijëve të pashoqëruar shqiptarë, përfshirë fëmijët shqiptarë të deklaruar të humbur, që ndodhen në territorin e një shteti të huaj;

c) e ripranimit në territorin e Republikës së Shqipërisë të fëmijëve të pashoqëruar nga vendet e treta apo pa shtetësi, si rrjedhojë e zbatimit të marrëveshjes së ripranimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian apo marrëveshjeve të tjera të ripranimit, ku Republika e Shqipërisë është palë.

2. Ky vendim nuk zbatohet për:

a) fëmijët e pashoqëruar që janë subjekte të kthimit apo të riatdhesimit në zbatim të ligjit penal apo si pasojë e zbatimit të një procedure ekstradimi;

b) fëmijët e shoqëruar vetëm nga njëri prind dhe pa pëlqimin e prindit tjetër, për të cilët, nga Ministria e Drejtësisë dhe autoritetet përgjegjëse shtetërore zbatohen rregullat dhe procedurat e parashikuara nga ligji nr. 9446, datë 24.11.2005, “Për ratifikimin e Konventës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës”. Rregullat e detajuara për procedurën e riatdhesimit në këtë rast përcaktohen me urdhër të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Brendshëm.

3. “Fëmijë i pashoqëruar” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

4. Qëllimi i këtij vendimi është të garantojë të drejtat e fëmijëve të pashoqëruar dhe t’u ofrojë atyre mbrojtjen më të lartë të mundshme, nëpërmjet përcaktimit të parimeve, procedurave dhe mekanizmave përgjegjës për fëmijët e pashoqëruar, sipas një sistemi të integruar mbrojtjeje dhe koordinimit efikas të të gjitha institucioneve shtetërore dhe organizatave jofitimprurëse, duke mbajtur në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës.

5. Autoriteti shtetëror përgjegjës, për të garantuar funksionimin e sistemit të integruar të mbrojtjes për fëmijët e pashoqëruar, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet bashkërendimit të punës midis autoriteteve përgjegjëse të përfshira në procesin e mbrojtjes, është Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

6. Mekanizmi i trajtimit dhe mbrojtjes së fëmijëve të pashoqëruar, si dhe procedurat e kthimit e riatdhesimit të tyre udhëhiqen nga parimet e parashikuara në ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

7. Kthimi apo riatdhesimi i fëmijëve të pashoqëruar bëhet vetëm nëse është në interesin më të lartë të tyre, ku veçanërisht duhet të vlerësohen elementet e mëposhtme:

a) nevojat individuale të fëmijës, në funksion të garantimit të mirërritjes së tij dhe gëzimit të të drejtave të fëmijës;

b) historia e fëmijës dhe gjendja e tij familjare, psikologjike, sociale apo kulturore;

c) dëshira dhe mendimi i fëmijës, në varësi të moshës biologjike dhe aftësisë së tij për të kuptuar;

ç) situata familjare dhe mundësia e saj për t’iu përgjigjur nevojave të fëmijës, si dhe ruajtja e marrëdhënieve familjare e shoqërore;

d) garantimi i interesit më të lartë të fëmijës, i bashkimit me familjen e tij apo vendosja e fëmijës nën përgjegjësinë e një kujdestari ligjor;

dh) siguria e dhënë nga autoritetet e vendit që aplikon kthimin, se fëmija do të bashkohet me familjen e tij, do të vendoset nën përgjegjësinë e një kujdestari ligjor apo në mjedise të përshtatshme pritjeje në shtetin drejt të cilit do të kthehet. Kthimi apo riatdhesimi i fëmijëve të



pashoqëruar, pa shtetësi apo nga vendet e treta bëhet duke mbajtur parasysh dhe duke respektuar parimin e moskthimit.

8. Rregullat e parashikuara në këtë vendim do të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me marrëveshje dypalëshe apo shumëpalëshe në këtë fushë, të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë, si dhe për aq sa janë më të favorshme për interesin e fëmijës.

## **II. Procedurat dhe rregullat e kthimit të fëmijëve të pashoqëruar, të huaj apo pa shtetësi, që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë**

9. Fëmija i pashoqëruar nuk mund të jetë në asnjë rast subjekt i ndonjë vendimi kthimi në pikat e kalimit të kufirit. Në rastet e tjera, kthimi është alternativa e fundit dhe vetëm në raste kur është në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës.

10. Punonjësit e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, punonjësit e Policisë së Shtetit apo të strukturave përgjegjëse për azilin ose refugjatët, brenda 12 orëve nga konstatimi apo njoftimi se në territorin e Republikës së Shqipërisë është paraqitur apo qëndron një fëmijë i pashoqëruar, referojnë rastin te punonjësi për mbrojtjen e fëmijës (në vijim, PMF) në territorin e së cilës është konstatuar fëmija, duke informuar zyrtarisht, në çdo rast, Agjencinë për Gjenealitetet dhe Shtetësinë e Fëmijës, nëse ato njihen, vendndodhjen e saktë të fëmijës, si dhe çdo të dhënë tjetër që tregon mënyrën e trajtimit e gjendjen e tij. Ata bëjnë verifikimin e menjëhershëm të moshës së fëmijës dhe, derisa mosha të përcaktohet saktësisht sipas legjislacionit në fuqi, ai prezumohet se është fëmijë dhe trajtohet si i tillë.

11. Në rastin e fëmijëve pa shtetësi, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin dhe Policia e Shtetit bëjnë të gjitha përpjekjet e mundshme për të gjetur vendbanimin e zakonshëm të fëmijës së pashoqëruar. Për këtë kategori, si pjesë e përcaktimit të interesit më të lartë të fëmijës, do të shqyrtohen të gjitha mundësitë për dhënien e një lejeje qëndrimi mbi baza humanitare nëse nuk plotësohen kushtet e tjera.

12. PMF-ja, në territorin e të cilit ndodhet fëmija, bën vlerësimin fillestar të rastit, nëpërmjet verifikimit të gjenealiteve, të vendbanimit dhe të shtetësisë së tij, të gjendjes e trajtimit që po i bëhet, si dhe përgatit një raport të hollësishëm informues

mbi arsyet e hyrjes dhe qëndrimit të pashoqëruar në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky raport përgatitet brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga momenti i raportimit të rastit dhe i përcillet agjencisë, sipas pikës 14, të këtij vendimi. PMF-ja ndjek hapat për caktimin që në fillim të një kujdestari ligjor për fëmijën e pashoqëruar, sipas legjislacionit në fuqi. Formatit tip i referimit të rastit dhe raportit që përgatit PMF-ja miratohet me urdhër të drejtorit të agjencisë.

13. Marrja e informacioneve nga fëmija bëhet me ndihmën e një psikologu apo të një të rrituri, që njih mirë natyrën e fëmijës apo që gëzon besimin e tij, dhe në gjuhën që ai kupton, nëpërmjet ofrimit të përkthyesit, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Agjencia i njofton listën e plotë të përkthyesve dhe psikologëve, që janë në dispozicion të PMF-së në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

14. Menaxhimi i rasteve për fëmijët e huaj të pashoqëruar, që ndodhen në Republikën e Shqipërisë, bëhet sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi. Në çdo rast, PMF-ja, në territorin e të cilit ndodhet fëmija, merr të gjithë hapat për ofrimin e shërbimit të emergjencës dhe vendosjen e masës emergjente të mbrojtjes e më pas referon rastin në bashkinë apo njësinë administrative ku ndodhet institucioni i përkujdesjes sociale ku do të vendoset fëmija. Plani individual për mbrojtjen e fëmijës duhet të përfshijë shqyrtimin e rrezikut për trafikimin e fëmijës ose sigurimin e regjistrimit nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin të kërkesës për azil e referimin përkatës tek autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët apo edhe të dy së bashku, nëse është rasti. PMF-ja, menaxher i rastit, i dërgon agjencisë një raport të hollësishëm lidhur me rastin, ku, përveç informacionit të përcaktuar në pikën 12, të këtij vendimi, pasqyrohet edhe mendimi i fëmijës lidhur me kthimin ose jo të tij.

15. Me udhëzimin e ministrit përgjegjës për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës përcaktohen institucionet dhe mënyra e ofrimit të shërbimit për fëmijët e huaj të pashoqëruar, që gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në rastin e fëmijëve të pashoqëruar azilkërkues, ata do të strehohen në Qendrën Kombëtare të Pritjes për Azilkërkues, kurse, në rastin e fëmijëve të pashoqëruar, që janë njëkohësisht edhe azilkërkues,



edhe viktimat apo viktimat të mundshme të trafikimit, ata do të vendosen në Qendrën Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit, ku do të vazhdojnë edhe procedurat e përcaktimit të statusit të refugjatit.

16. Agjencia, pas marrjes dijeni zyrtarisht për rastin, nëpërmjet shërbimit diplomatik të vendit të origjinës së fëmijës, vendit ku ndodhet familja e tij, vendit nga ai ka ardhur apo vendit ku ka vendbanimin e tij, informon autoritetet përgjegjëse të atij shteti për vendndodhjen e fëmijës dhe arsyet e hyrjes dhe qëndrimit të tij të pashoqëruar. Agjencia u kërkon autoriteteve përgjegjëse të atij shteti që, brenda një afati të arsyeshëm, të bëjnë një vlerësim të thelluar dhe të paraqesin një informacion të hollësishëm për fëmijën, veçanërisht për prindërit apo kujdestarin ligjor të fëmijës, si dhe aspektet që lidhen me sigurinë e fëmijës, integrimin e tij në vendin e origjinës, kushtet e jetesës pas kthimit të mundshëm në vendin e origjinës, si dhe mundësitë e tij për të ruajtur identitetin, kombësinë dhe lidhjet familjare.

17. Raporti i paraqitur nga autoritetet kompetente të vendit të origjinës i përcillet menjëherë autoritetit që ka njoftuar identifikimin e fëmijës, PMF-së, institucionit të përkujdesjes sociale, ku po qëndron fëmija i pashoqëruar, si dhe institucionit që po trajton kërkesat ligjore të paraqitura nga fëmija i pashoqëruar. Raporti i vihet në dispozicionin edhe kujdestarit ligjor që i është caktuar fëmijës për periudhën e qëndrimit në Shqipëri. Përgjatimisht, në rastin e fëmijës së pashoqëruar që ka paraqitur kërkesë për azil, informacioni sipas pikës 16, të këtij vendimi, kërkohet vetëm pasi ka marrë formë të prerë vendimi për mospranimin/refuzimin ose revokimin e statusit mbrojtje ndërkombëtare.

18. Agjencia, pas shqyrtimit të këtij raporti, si dhe të raportit të dërguar nga PMF-ja, përgjegjëse për menaxhimin e rastit, paraqet në formë shkresore mendimin për autoritetet përgjegjëse që po trajtojnë kërkesa të fëmijës për mundësinë e qëndrimit ose jo të tij në Shqipëri, duke mbajtur në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës.

19. Struktura pranë ministrisë përgjegjëse për azilin dhe refugjatët, si dhe autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin, gjatë vendimmarrjes së tyre për aplikimin për azil, statusin e refugjatit apo për të përfituar të drejtën e qëndrimit në Shqipëri, mbajnë në konsideratë, për

aq sa është e mundur, mendimin e paraqitur nga agjencia, si dhe informacione të tjera të marra nga autoritetet përgjegjëse të vendit të origjinës, në vijim të kërkesave të tyre, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

20. Vendimmarrja për kthimin ose jo të fëmijës nuk mund të merret në asnjë rast pa u paraqitur më parë mendimi i arsyetuar i agjencisë. Ky mendim duhet të mbahet në konsideratë nga autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin, me përjashtim të rasteve kur ka arsye të argumentuara e të përligjura, që bëjnë të pamundur zbatimin e tij, ku përfshihen, por pa u kufizuar, rreziku ndaj sigurisë kombëtare apo rendit publik apo rrezikimi i jetës së fëmijës.

21. Vendimi për kthimin ose jo të fëmijës merret brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e mendimit të arsyetuar nga agjencia.

22. Nëse autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin vlerëson se fëmija i pashoqëruar duhet të kthehet, atëherë lëshon urdhrin e largimit dhe kthimit të fëmijës së pashoqëruar, i cili duhet të jetë i arsyetuar dhe në çdo rast duhet të përcaktojë afatin maksimal brenda të cilit duhet të zbatohet.

23. Në rast dhe vetëm nëse fëmijës së pashoqëruar i është refuzuar ose nuk i është pranuar aplikimi për azil, leje qëndrimi apo i është revokuar vendimi i statusit të refugjatit, si rregull, mund të bëhet subjekt i kthimit dhe largimit nga territori shqiptar, sipas përcaktimeve në ligjin për të huajt.

24. Urdhri i largimit dhe kthimit të fëmijës së pashoqëruar u njoftohet menjëherë agjencisë dhe PMF-së që ka ndjekur zbatimin e planit individual të mbrojtjes së fëmijës.

25. PMF-ja, brenda 3 (tri) ditëve nga dita e njohjes me urdhrin e largimit dhe të kthimit të fëmijës, me ndihmën e një psikologu apo të një të rrituri, informon fëmijën, në gjuhën që ai kupton, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar, për urdhrin e largimit dhe të kthimit të tij.

26. Fëmija i pashoqëruar, nëpërmjet kujdestarit ligjor të caktuar, ka të drejtën e ankimit administrativ dhe gjyqësor, sipas legjislacionit në fuqi. Ai përfiton ndihmë juridike falas nga shteti, nëse e kërkon një gjë të tillë, sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.



27. Urdhri i largimit nuk ekzekutohet deri në përfundimin e procesit të ankimit dhe marrjen e vendimit përfundimtar, përveçse kur është përcaktuar ndryshe në ligjin për të huajt.

28. Autoritetet përgjegjëse, bazuar në rrethanat specifike të fëmijës, si kohëzgjatja e qëndrimit, vijimi i shkollës apo çështje të tjera me karakter social apo familjar, mund të urdhërojnë zgjatjen e periudhës për realizimin e procedurës së kthimit.

29. Brenda 3 (tri) ditëve nga momenti i nxjerrjes së urdhrit për largimin e fëmijës së pashoqëruar dhe kthimin e tij, autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin përgatit planin e kthimit të fëmijës, si dhe bashkëpunon me autoritetet përgjegjëse të vendit ku do të kthehet fëmija, për të përcaktuar në mënyrë përfundimtare, si më poshtë vijon:

a) mënyrën e kthimit dhe rrugën më të përshtatshme për transportin e fëmijës;

b) kohën e kthimit, ku përfshihet orari i mundshëm i nisjes nga territori i Shqipërisë dhe të mbërritjes në vendin e kthimit;

c) personat përgjegjës për shoqërimin e dorëzimit të fëmijës, si dhe dokumentacionin e nevojshëm që nevojitet të përgatitet për dorëzimin e tij;

ç) pikat e kontaktit ndërmjet autoriteteve, me qëllim lehtësimin e procedurës së kthimit dhe të dorëzimit të fëmijës;

d) nevojën për marrjen e masave paraprake për të garantuar të drejtat e fëmijës, çka mund të çojë në mbajtjen e ndaluar të fëmijës vetëm si një mjet i fundit;

dh) mundësinë e mbulimit të shpenzimeve përkatëse të procedurës së kthimit dhe të dorëzimit.

30. Plani i kthimit të fëmijës përfshin, por pa u kufizuar, si më poshtë vijon:

a) Rregullat për përgatitjen e kthimit të fëmijës, duke përfshirë mënyrën e transportit të tij nga vendqëndrimi deri në pikën e kalimit të kufirit;

b) Garantimin e ushqimit dhe të higjienës së fëmijës gjatë gjithë udhëtimit deri në momentin e dorëzimit tek autoritetet përgjegjëse të vendit ku do të kthehet;

c) Personin përgjegjës për shoqërimin e fëmijës nga vendqëndrimi i tij deri në dorëzimin tek autoritetet përgjegjëse të vendit ku do të kthehet;

ç) Detyrat dhe përgjegjësitë e personit përgjegjës për shoqërimin e fëmijës;

d) Përgjegjësitë e të gjitha autoriteteve përgjegjëse të përfshira në procedurën e kthimit të fëmijës, për të mundësuar kthimin e përshtatshëm të tij;

dh) Mënyrën e kalimit të kufirit dhe rregullat për dorëzimin e fëmijës;

e) Dokumentacionin e nevojshëm për kthimin e fëmijës.

Një kopje e planit të kthimit të fëmijës i dërgohet agjencisë.

31. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin njofton autoritetin përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve në vendin, ku fëmija do të kthehet, për planin e kthimit të fëmijës, me qëllim marrjen e masave prej tyre për të siguruar mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të fëmijës.

32. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin merr menjëherë masat për të pajisur fëmijën me dokument identifikimi të vlefshëm, nëse fëmija nuk e disponon, si dhe me dokumentet e vlefshme të udhëtimit.

33. Në përcaktimin e mënyrës së kthimit dhe rrugës më të përshtatshme për transportin e fëmijës mbahet në konsideratë interesi më i lartë i fëmijës dhe mundësia për të siguruar kthimin më të lehtë, të shpejtë dhe të përshtatshëm të tij, në përputhje me moshën dhe mundësinë për të përballuar pa asnjë vështirësi kthimin, duke garantuar dinjitetin, nderin dhe personalitetin e fëmijës.

34. PMF-ja, me ndihmën e një psikologu apo të një të rrituri, informon fëmijën në gjuhën që ai kupton dhe në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar me planin e kthimit të fëmijës, situatën e përgjithshme sociale, ekonomike, si dhe shërbimet që do t'i ofrohen në vendin e origjinës.

35. Si rregull, fëmija shoqërohet nga kujdestari i tij ligjor gjatë udhëtimit e deri në dorëzimin tek autoritetet përgjegjëse. Nëse kjo është e pamundur, fëmija shoqërohet nga një psikolog apo një i rritur, që njeh mirë natyrën e fëmijës apo që gëzon besimin e tij.

36. Dorëzimi i fëmijës tek autoritetet përgjegjëse të vendit të kthimit dokumentohet rregullisht, nëpërmjet procesverbalit të dorëzimit të fëmijës, ku përshkruhet në mënyrë të detajuar ecuria e udhëtimit dhe personat përgjegjës që po marrin në dorëzim fëmijën. Procesverbali nënshkruhet në tri kopje nga personat përgjegjës që kanë marrë në dorëzim fëmijën dhe personi përgjegjës për



shoqërimin e tij. Një kopje e procesverbalit i dërgohet agjencisë.

37. Shpenzimet për kthimin e fëmijës dhe garantimin e të drejtave deri në momentin e dorëzimit, në rast se nuk mbulohen nga vendi ku do të kthehet fëmija ose nga familja e fëmijës përballohen nga buxhetet e miratuara të institucioneve përgjegjëse. Në përputhje me parimin e reciprocitetit apo të marrëveshjeve ndërkombëtare të zbatueshme, të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë, mund të kërkohej rimbursimi i shpenzimeve nga vendi ku fëmija kthehet apo nga familja e tij.

III. Procedurat dhe rregullat për riatdhesimin e fëmijëve të pashoqëruar shqiptarë, që ndodhen në territorin e një shteti të huaj

38. Për rastet që përfshijnë fëmijët e pashoqëruar, si dhe fëmijët e pashoqëruar të deklaruar të humbur, shërbimi diplomatik i Republikës së Shqipërisë jashtë vendit njofton menjëherë Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Kjo ministri apo çdo autoritet tjetër shtetëror, duke përfshirë edhe Departamentin për Kufirin dhe Migracionin, që merr njoftim nga autoritetet e huaja për vendndodhjen e një fëmije të pashoqëruar shqiptar në territorin e një vendi të huaj, brenda 24 orëve, njofton zyrtarisht Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

39. Njoftimi duhet të përmbajë gjenealogjetet e fëmijës, nëse ato njihen, vendndodhjen e saktë të fëmijës, historikun e fëmijës në vendin ku ndodhet, nëse njihet, vendbanimin e familjes, emrat e të afërmeve apo emrin e shkollës, si dhe çdo të dhënë tjetër që tregon mënyrën e trajtimit dhe gjendjen e tij, sipas informacionit të përcjellë nga autoritetet përgjegjëse të vendit ku ndodhet fëmija.

40. Agjencia, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, Policinë e Shtetit dhe organet e pushtetit vendor, brenda 10 (dhjetë) ditëve, verifikon gjenealogjetet e sakta të fëmijës dhe vendbanimin e familjes së tij, prindin apo kujdestarin ligjor të fëmijës, adresën e saktë të tyre, periudhën dhe mënyrën e kalimit të kufirit, si dhe konfirmon në mënyrë përfundimtare se kemi të bëjmë me një shtetas shqiptar.

41. Agjencia referon rastin të punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, në territorin e së cilës ka vendbanimin fëmija apo vendqëndrimin familja e tij.

42. PMF-ja, në bashkëpunim me administratorin shoqëror, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga momenti i njoftimit nga agjencia, bëjnë një vlerësim të thelluar, përgatitin dhe dërgojnë pranë agjencisë një raport të hollësishëm informues për:

a) gjendjen familjare të fëmijës dhe gjenealogjetet e plota të prindit apo kujdestarit ligjor të tij;

b) qëndrimin e familjes dhe të të afërmeve të tyre për fëmijën;

c) historikun e fëmijës e të familjes së tij, si dhe gjendjen ekonomike e sociale të familjes së fëmijës;

ç) aspektet që lidhen me sigurinë e fëmijës, integritetin e tij në Shqipëri pas riatdhesimit të mundshëm apo mundësinë e familjes së tij për t'u përkujdesur për fëmijën pas riatdhesimit, me qëllim ruajtjen e identitetit, kombësisë dhe lidhjeve familjare.

43. Marrja e informacioneve për përgatitjen e raportit bëhet nëpërmjet:

a) verifikimit në terren të gjendjes dhe kushteve të jetesës së familjes;

b) pyetjes së prindërve apo kujdestarit ligjor të fëmijës, të afërmeve të tij, apo institucioneve apo personave që kanë ofruar shërbime ndaj fëmijës;

c) shqyrtimit të informacioneve zyrtare që ekzistojnë për familjen apo fëmijën, veçanërisht për sa u përket rasteve të raportuara më parë të dhunës në familje, shfrytëzimit të paligjshëm në çdo formë të fëmijës apo përfshirjes së fëmijës a familjarëve të tij në veprimtari kriminale;

ç) verifikimeve nëse familja e fëmijës është përfituese e ndihmës ekonomike apo e shërbimeve sociale, sipas legjislacionit në fuqi;

d) verifikimit nëse fëmija është trajtuar më parë me ndonjë nga format e shërbimeve sociale apo të përkujdesjes alternative;

dh) çdo formë tjetër që mundëson mbledhjen e informacioneve të vlefshme për të përcaktuar çështjet që do të përfshihen në raportin informues.

44. Agjencia, brenda 3 (tri) ditëve nga marrja e raportit informues, ia përcjell atë zyrtarisht autoritetit njoftues, duke i kërkuar që raporti t'i njoftohet edhe:

a) organit përgjegjës që ka bërë njoftimin dhe po kujdeset për trajtimin e fëmijës shqiptar të pashoqëruar;

b) kujdestarit ligjor që mund t'i jetë caktuar fëmijës;



c) organeve përgjegjëse që po trajtojnë ndonjë kërkesë ligjore të paraqitur nga fëmija në atë vend.

45. Nëse autoritetet shtetërore marrin njoftim për një vendim për kthimin e një fëmije shqiptar të pashoqëruar nga një vend i huaj, menjëherë ia komunikojnë atë agjencisë, e cila i përcjell njoftimin PMF-së, që ka përgatitur raportin informues.

46. Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, që i paraqitet për zbatim vendimi i autoritetit kompetent të huaj, për të kthyer një fëmijë të pashoqëruar shqiptar, apo në rastet e paraqitjes së kërkesave për ripranimin e fëmijëve të pashoqëruar, në kuadër të zbatimit të marrëveshjes ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian ose të marrëveshjeve dypalëshe të ripranimit, dakordësojnë me autoritetet përgjegjëse të atij vendi:

a) rregullat për përgatitjen e riatdhesimit të fëmijës, duke përfshirë mënyrën e transportit të tij nga vendqëndrimi deri në pikën e kalimit të kufirit në Shqipëri;

b) personin përgjegjës për shoqërimin e fëmijës dhe dorëzimin e tij tek autoritetet shqiptare;

c) kohën e kthimit, ku përfshihet orari i mundshëm i nisjes dhe i mbërritjes në territorin e Shqipërisë;

ç) mënyrën e kalimit të kufirit, si dhe rregullat e dokumentacionin e nevojshëm për riatdhesimin dhe dorëzimin e fëmijës;

d) mbulimin ose jo të shpenzimeve të riatdhesimit.

47. Rregullat e dakordësuara ndërmjet autoriteteve i njoftohen menjëherë agjencisë, e cila ia përcjell për njohje PMF-së që ka përgatitur raportin informues, me qëllim që, së bashku me punonjësën e sektorit të Migracionit në Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, ato t'i bëhen me dije edhe familjes së fëmijës së pashoqëruar apo kujdestarit të tij ligjor.

48. PMF-ja përgatit planin individual të mbrojtjes së fëmijës për zbatim pas riatdhesimit të tij.

49. Në rast se në të njëjtën periudhë janë paraqitur më shumë se një vendim i autoritetit kompetent të huaj, për të kthyer një fëmijë të pashoqëruar shqiptar nga i njëjti shtet, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin organizon dhe komunikon me autoritetet përgjegjëse të huaja, që riatdhesimi i tyre të bëhet në mënyrë të njëkohshme.

50. Punonjësi i sektorit të migracionit në Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, së bashku me PMF-në, njoftojnë prindërit ose kujdestarin ligjor të fëmijës për detajet e riatdhesimit të fëmijës. Prindërit ose kujdestari ligjor i fëmijës plotësojnë “Deklaratën e marrjes dijeni për riatdhesimin”, ku shprehen në mënyrë përfundimtare, nëse:

a) marrin përsipër ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, të strehimit dhe mirërritjen e fëmijës në kushte normale jetese;

b) bëhet pritja e fëmijës në momentin e mbërritjes në territorin shqiptar;

c) mundësohet mbulimi i shpenzimeve për transportin e fëmijës.

51. Deklarata e marrjes dijeni për riatdhesimin plotësohet në katër kopje dhe i dorëzohet punonjësit të sektorit të migracionit në Drejtorinë Rajonale për Kufirin, PMF-së përgjegjëse, i cili ia përcjell një kopje agjencisë.

52. Plani individual i riatdhesimit dhe trajtimit të fëmijës, i hartuar nga shteti njoftues, u njoftohet menjëherë prindërve apo kujdestarit ligjor të fëmijës, nëse ata kanë shprehur vullnetin për pritjen e fëmijës, Drejtorisë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, që ka në juridiksion pikën e kalimit të kufirit, ku do të dorëzohet fëmija, dhe PMF-së.

53. Në përcaktimin e mënyrës më të përshtatshme për transportin e fëmijës, mbahet në konsideratë interesi i tij dhe mundësia për të siguruar transportin më të lehtë, të shpejtë dhe të përshtatshëm të fëmijës, në përputhje me moshën dhe mundësinë për të përballuar pa asnjë vështirësi atë, duke garantuar dinjitetin, nderin dhe personalitetin e fëmijës.

54. Fëmija i pashoqëruar pritët në pikën e kalimit të kufirit nga prindi ose kujdestari i tij ligjor, nëse kanë shprehur dakordësinë e tyre paraprakisht nga një psikolog dhe nga PMF-ja që ka koordinuar të gjithë procedurën e vlerësimit.

55. Fëmija shoqërohet në familje menjëherë pas mbërritjes në territorin shqiptar. Nëse fëmija do të vendoset në një institucion përkujdesjeje, atëherë PMF-ja e territorit ku është pika e kalimit të kufirit bën shoqërimin e fëmijës për në institucionin e përkujdesjes, pasi është bërë kërkesa më parë në Shërbimin Social Shtetëror, ku janë dhënë arsyet e vendosjes së fëmijës në institucionin e përkujdesjes.

56. Brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga mbërritja e fëmijës në familje, PMF-ja, i shoqëruar nga një



psikolog apo administratori shoqëror, bën një vlerësim për gjendjen psikosociale, shëndetësore, duke identifikuar dhe nevojat e fëmijës për riintegrim në jetën sociale.

57. Fëmija i riadhesuar është fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe trajtohet sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi. PMF-ja fillon procedurën për vendosjen e masës së mbrojtjes kur:

a) nëse nga vlerësimi i thelluar i bërë nga PMF-ja dhe administratori shoqëror rezulton se nuk është në interesin më të lartë të fëmijës të qëndrojë në familje;

b) në rastin kur prindërit apo kujdestari i fëmijës nuk pranon që fëmija i tyre të kthehet në familje, edhe pse nga vlerësimi i thelluar ka rezultuar se familja i plotëson kushtet për t'u kujdesur për fëmijën, duke përfshirë edhe ofrimin e ndihmës për përmirësimin e kushteve të jetesës.

58. Në çdo rast të përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 57, të këtij vendimi, PMF-ja raporton rastin pranë Drejtorisë Vendore të Policisë së Shtetit për kryerjen e verifikimeve të nevojshme dhe sipas rrethanave të rastit, fillimin e procedimit penal ndaj prindit ose kujdestarit ligjor të fëmijës, bazuar në nenin 124, të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, “Braktisja e fëmijëve të mitur”.

59. Nëse autoritetet shtetërore marrin njoftim për një vendim për kthimin e një fëmije shqiptar të pashoqëruar nga një vend i huaj, pa njoftim paraprak dhe brenda një kohe të shkurtër, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin apo çdo autoritet tjetër shtetëror, që i paraqitet për zbatim vendimi i autoritetit kompetent të huaj, për të kthyer një fëmijë të pashoqëruar shqiptar, njofton menjëherë agjencinë, e cila referon për ndjekje rastin pranë PMF-së ku ka vendbanimin ose vendqëndrimin fëmija dhe familja e tij.

60. Nëse afati i përcaktuar për kthimin e fëmijës nuk mundëson që fëmija të pritë në pikën e kalimit të kufirit, nga subjektet e përcaktuara në pikën 54, të këtij vendimi, atëherë fëmija, menjëherë pas mbërritjes në territorin shqiptar dhe marrjes në dorëzim, shoqërohet për në qendrën e emergjencës, në qendrën ditore ose në qendrën rezidenciale të shërbimit social, që ndodhet në territorin e bashkisë më të afërt, ku qëndron përkohësisht deri në vlerësimin e plotë të gjendjes së tij psikosociale dhe shëndetësore

dhe marrjen e vendimit për kthimin ose jo të fëmijës në familje.

61. Marrja në dorëzim i fëmijës së pashoqëruar shqiptar që i nënshtrohet procedurës së riadhesimit dokumentohet rregullisht, nëpërmjet procesverbalit të marrjes në dorëzim të fëmijës, ku përshkruhet në mënyrë të detajuar procedura e pritjes, gjendja e tij e dukshme në momentin e marrjes në dorëzim dhe personat përgjegjës që po marrin në dorëzim fëmijën.

62. Procesverbali nënshtrohet në 4 (katër) kopje nga personat përgjegjës që kanë marrë në dorëzim fëmijën dhe personi përgjegjës për shoqërimin e tij. Një kopje e procesverbalit i dorëzohet agjencisë.

63. PMF-ja, brenda një periudhë gjashtëmujore, dërgon pranë agjencisë raporte periodike dymujore për ecurinë e menaxhimit të rasteve të fëmijëve të riadhesuar.

64. Shpenzimet për kthimin e fëmijës dhe garantimin e të drejtave, në rast se nuk mbulohen nga vendi nga i cili kthehet fëmija dhe për aq sa nuk mbulohen nga familja e fëmijës, përballohen nga buxhetet e miratuara të institucioneve përgjegjëse.

#### **IV. Ruajtja dhe administrimi i të dhënave**

65. Agjencia mban të dhëna statistikore për fëmijët e pashoqëruar që i nënshtrohen procedurës së kthimit apo riadhesimit. Të dhënat statistikore përpunohen në format elektronik dhe përfshijnë, si më poshtë vijon:

a) në rastin e kthimit, përveç gjenealiteteve të fëmijës dhe vendit të tij të origjinës apo vendit nga ka ardhur dhe ku ka vendbanimin, edhe mënyrën e trajtimit të tij në Shqipëri dhe procedurën e ndjekur për kthimin e tij;

b) në rastin e riadhesimit, gjenealitetet e fëmijës, vendin nga ku është kthyer, situatën e familjes, procedurat e ndjekura për riadhesim, si dhe mënyrën e trajtimit të tij nga mbërritja në Shqipëri.

66. Autoritetet përgjegjëse që ushtrojnë detyrat sipas këtij vendimi, të cilat mbledhin dhe administrojnë të dhënat për fëmijën e pashoqëruar, i ruajnë ato për një periudhë 5-vjeçare, nga momenti i dorëzimit të fëmijës tek autoritetet përgjegjëse të vendit ku është kthyer apo nga momenti i marrjes në dorëzim të fëmijës së riadhesuar.

67. Autoritetet që mbledhin dhe administrojnë të dhëna personale për fëmijët e pashoqëruar marrin masat e duhura organizative dhe teknike për





mbrojtjen e të dhënave personale nga shkatërrimi i jashtëligjshëm ose aksidental, humbja aksidentale, aksesit ose përhapja të persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave kryhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër përpunimi të jashtëligjshëm.

68. Punonjësit e autoritetit përgjegjës të përfshira në procedurën e trajtimit dhe kthimit apo riatdhimit të fëmijëve të pashoqëruar i nënshtrohen detyrimit të ruajtjes së konfidencialitetit dhe mospërhapjes së informacionit të marrë, për shkak të detyrës gjatë mbledhjes, ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale për trajtimin e tyre, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre edhe pas përfundimit të funksioneve, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.

#### V. Dispozita të fundit

69. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, brenda 1 (një) muaji nga miratimi i këtij vendimi, komunikon me autoritetet përgjegjëse të shteteve të tjera që, menjëherë sapo konstatojnë gjetjen e një fëmije me shtetësi shqiptare të pashoqëruar në territorin e tyre, të njoftojnë misionin diplomatik postin konsullor të Republikës së Shqipërisë të akredituar në vendin e tyre.

70. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, në përmbushjen e kësaj përgjegjësie, bashkëpunon edhe me organizatat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

71. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Shërbimi Social Shtetëror, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
**Erion Braçe**

## VENDIM

Nr. 113, datë 6.3.2019

### PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE QË PËRFAQËSOJNË PALËN SHQIPTARE NË KOMISIONIN SHQIPTARO-MALAZEZ PËR MENAXHIMIN E UJËRAVE ME INTERES TË PËRBASHKËT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16, të kreut III, të marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për marrëdhëniet e ndërsjella në menaxhimin e burimeve ujore ndërkufitare, miratuar me vendimin nr. 745, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave,

#### VENDOSI:

1. Emërimin e anëtarëve që përfaqësojnë palën shqiptare në komisionin shqiptaro-malazez për menaxhimin e ujërave me interes të përbashkët, në zbatim të marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për marrëdhëniet e ndërsjella në menaxhimin e burimeve ujore ndërkufitare, miratuar me vendimin nr. 745, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, të përbërë, si më poshtë vijon:

- |     |   |          |
|-----|---|----------|
| a)  | Znj. Gerta Lubonja, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore                                     | kryetar; |
| b)  | Z. Arben Mukaj, Ministria për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural                                    | anëtar;  |
| c)  | Znj. Mira Hoxha, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme                                      | anëtar;  |
| c)  | Z. Astrit Shatro, Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit                       | anëtar;  |
| d)  | Z. Kristaq Qirko, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor                          | anëtar;  |
| dh) | Z. Ermal Kacurri, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare  | anëtar;  |
| e)  | Z. Arben Pambuku, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar  | anëtar;  |
| ë)  | Z. Neritan Postoli, Agjencia Kombëtare e Mjedisit   | anëtar;  |
| f)  | Z. Maksimiljan Dhima, Drejtorja e Përgjithshme e Emergjencave Civile, në Ministrinë e Mbrojtjes | anëtar;  |
| g)  | Z. Arduen Karagozi, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore                                     | anëtar.  |



2. Punët administrative për nevojat e komisionit, për palën shqiptare, do të kryhen nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore.

3. Anëtarët e komisionit shqiptaro-malazez për menaxhimin e ujërave me interes të përbashkët raportojnë, në mënyrë periodike, për veprimtarinë e tyre pranë Komisionit të Posaçëm për Administrimin e Ujërave Ndërkufitare.

4. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, Koorporata Elektroenergjete Shqiptare, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
Erion Braçe

**UDHËZIM**  
Nr. 1, datë 6.3.2019

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 4, DATË 12.12.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR CAKTIMIN E MASËS SË SHPENZIMEVE DHE PAGESAVE TË EKSPERTËVE DHE DËSHMITARËVE GJATË PROCESIT GJYQËSOR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 105/a, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Në udhëzimin nr. 4, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në ndarjen I, pikat 2, 3 dhe 4 ndryshohen me këtë përmbajtje:

“2. Gjykata thërret ekspertë që ofrojnë ekspertizë në një proces gjyqësor, mbështetur në të dhënat e Regjistrit Elektronik të Ekspertëve,

që administrojnë dhe vë në dispozicion Ministria e Drejtësisë.

3. Gjykata, pa cenuar administrimin e drejtësisë, bën përzgjedhjen e ekspertëve në mënyrë të drejtë dhe transparente, duke konsideruar që çdo eksperti nuk mund t'i caktohet për të ofruar ekspertizën e tij më shumë se 30% e numrit të çështjeve gjyqësore për të cilat është kërkuar e njëjta lloj ekspertize, brenda një viti kalendarik. Kjo mënyrë caktimi nga gjykata siguron një nivel transparence të përshtatshme lidhur me përzgjedhjen e ekspertëve përmes mjeteve informatike.

4. Gjykata thërret një ekspert jashtë Regjistrat Elektronik të Ekspertëve, vetëm kur, për nevoja të procesit, eksperti nevojitet nga fusha të veçanta ekspertize, për të cilat ligji nuk parashikon licencimin e tyre.”

2. Në ndarjen V, pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Pagesat për ekspertët dhe dëshmitarët, në rastet kur gjykata ka vendosur përjashtimin nga pagesa e shpenzimeve gjyqësore në kuptim të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, kryhen nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, sipas rregullave dhe procedurës së përcaktuar në udhëzimin e ministrit të Drejtësisë.”

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
Erion Braçe

**UDHËZIM**  
Nr. 6, datë 25.2.2019

**PËR FUNKSIONET, AUTORITETIN DHE PËRGJEGJËSITË E AVOKATIT TË TATIMPAGUESVE, PROCEDURAT QË DO TË ZBATOHEN PREJ TIJ NË MBROJTJE TË INTERESAVE TË TATIMPAGUESVE, SI DHE PROCEDURAT QË DUHET TË NDIQEN NGA TATIMPAGUESIT, PËR TË PËRFITUAR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË TYRE NGA AVOKATI I TATIMPAGUESVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 105/2, të ligjit nr. 9920, datë



19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 648, datë 28.7.2010, “Për Avokatin e Tatimpaguesve”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë

#### UDHËZON:

##### **Qëllimi i udhëzimit**

Ky udhëzim ka për qëllim rregullimin e procedurave që duhet të ndiqen nga Avokati i Tatimpaguesve dhe tatimpaguesit për zbatimin e nenit 105/2, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 648 të Këshillit të Ministrave, datë 28.7.2010, “Për Avokatin e Tatimpaguesve”, të ndryshuar. Ai synon të rregullojë organizimin, funksionimin, përgjegjësitë dhe procedurat që duhet të zbatohen nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesve në ofrimin e shërbimit ndaj taksapaguesve në mbrojtjen e të drejtave të tyre në përputhje me dispozitat e përcaktuara në legjislacionin tatimor. Gjithashtu, ky udhëzim përcakton dhe procedurat që duhet të ndiqen nga tatimpaguesit, me qëllim përfitimin e shërbimit nga Avokati i Tatimpaguesve.

Rregullimet e përshkruara në këtë udhëzim për Avokatin e Tatimpaguesit, synojnë të japin, në mënyrë të qartë e të detajuar, rolin, përgjegjësitë dhe kompetencat, si edhe procedurat administrative për t'u ndjekur nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit.

##### **1. Misioni i Avokatit të Tatimpaguesit**

1.1 Avokati i Tatimpaguesve ka për mision të mbrojë interesat e tatimpaguesve në marrëdhëniet me organet tatimore. Ky mision realizohet kryesisht nëpërmjet kompetencës së tij për të investiguar të gjitha kërkesat e tatimpaguesve, që përmbajnë probleme të administrimit të tatimeve, si vonesa administrative të paarsyeshme, gabime të zyrtarëve tatimorë, që nuk janë zgjidhur në mënyrën e duhur pas paraqitjes nga tatimpaguesi, mosrespektimi i procedurave tatimore apo shkelje të procedurave tatimore nga zyrtarët tatimorë. Ai ka të drejtë të urdhërojë kryerjen e të gjitha verifikimeve apo hetimeve në drejtoritë rajonale tatimore dhe/ose drejtoritë funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, si dhe nëpërmjet kompetencave këshillimore tek autoritetet kompetente për zgjidhjen e problemeve të tatimpaguesve. Çdo vendim për të ndërmarrë

masat korrigjuese i takojnë administratës tatimore dhe jo Avokatit të Tatimpaguesve. Avokati i Tatimpaguesve, në rast se nuk gjen zgjidhje për një çështje të caktuar, gëzon të drejtën ta ngrejë nivelin e verifikimit dhe të investigimit deri në nivelin më të lartë të drejtimit të administratës tatimore, që është Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

1.2 Avokati i Tatimpaguesve, në ushtrimin e funksioneve dhe detyrave të tij është i udhëhequr nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit dhe profesionalizmit dhe e ushtron veprimtarinë në mbrojtje të të drejtave të tatimpaguesve.

1.3 Avokati i Tatimpaguesve promovon të drejtat e tatimpaguesve. Ai ka një rol të rëndësishëm në grumbullimin dhe në përhapjen e informacionit, lidhur me të drejtat e tatimpaguesve dhe edukimin e tyre.

1.4 Avokati i Tatimpaguesve siguron një informacion nga rastet e trajtuara, bën analiza përgjithësuese dhe ua prezanton ato hallkave administrative përkatëse, duke propozuar dhe rrugët për zgjidhjen e problemeve dhe përmirësimin e procedurave.

##### **2. Organizimi i Avokatit të Tatimpaguesit**

2.1 Avokati i Tatimpaguesve është strukturë e pavarur në vendimmarrje në përbërje të ministrisë përgjegjëse për financat. Funksionimi i strukturës së Avokatit të Tatimpaguesve është i organizuar në nivel drejtorie, në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale. Gjithashtu, ai raporton dhe informon mbi veprimtarinë e tij dhe përpara Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë përgjegjëse për financat.

2.2 Avokati i Tatimpaguesve emërohet sipas dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Ai raporton drejtpërdrejt përpara Drejtorit të Përgjithshëm në varësi të të cilit është nga ana funksionale, Sekretarit të Përgjithshëm dhe ministrit përgjegjës për financat dhe funksionon në cilësinë e përfaqësuesit direkt të tyre, në marrëdhëniet me administratën tatimore dhe me publikun. Ashtu si Sekretari i Përgjithshëm apo ministri përgjegjës për financat, ai gëzon autoritetin unik për t'u marrë drejtpërdrejt me drejtuesit dhe punonjësit në të gjitha funksionet e të gjitha niveleve të administratës tatimore, kur një gjë e tillë është e përshtatshme. Për të nxitur përgjegjshmërinë, është më mirë që shumica e



veprimeve të fillojnë nga drejtuesit, edhe pse në të mirë të shpejtësisë, një gjë e tillë nuk do të jetë gjithmonë e përshtatshme.

2.3 Marrëdhëniet e punës për personelin e stafit në varësi të Avokatit të Tatimpaguesit rregullohen në përputhje me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil.

2.4 Avokati i Tatimpaguesve mund të jetë çdo person që plotëson këto kushte:

a) të ketë njohuri të mjaftueshme për sistemin tatimor në Shqipëri;

b) të ketë eksperiencë pune në administratën tatimore;

c) të shquhet për aftësi profesionale dhe figurë të pastër etiko-morale;

d) të ketë aftësi të forta ndërpersonale komunikimi.

### 3. Funksionet, autoriteti dhe detyrat e Avokatit të Tatimpaguesit

3.1 Avokati i Tatimpaguesve ka këto funksione:

a) evidenton, klasifikon dhe trajton me drejtësi çdo ankesë të marrë nga tatimpaguesit;

b) bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT), si dhe drejtorinë e shërbimit të tatimpaguesve pranë DPT-së, për të promovuar rolin e Avokatit të Tatimpaguesit në mbrojtjen e të drejtave të tatimpaguesit;

c) bashkëpunon me Drejtorinë e Auditimit në ministrinë përgjegjëse për financat, si dhe me DPT-në dhe drejtoritë e saj rajonale tatimore, për të garantuar që tatimpaguesit të trajtohen apo do të trajtohen në përputhje me dispozitat ligjore dhe se të drejtat e tyre mbrohen dhe respektohen në mënyrën e duhur nga punonjësit e administratës tatimore, në përputhje me Kodin e Etikës;

ç) ndjek dhe trajton me korrektësi çdo rast individual dhe bën mbylljen e arkivimit të tyre, vetëm pasi ankesat të jenë trajtuar e zgjidhur në përputhje me legjislacionin tatimor, dispozitat e Kodit të Etikës dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit për procedurat tatimore;

d) bashkëpunon me strukturat përkatëse të varësisë në DPT, si të shërbimit të tatimpaguesve, të trajnimit dhe të burimeve njerëzore, me qëllim që nga përfundimet e nxjerra nga rastet e veçanta në të gjitha drejtoritë rajonale tatimore apo drejtoritë operative në DPT, të garantohet mospërsëritja e gabimeve;

dh) bën propozime në strukturat drejtuese të drejtorive rajonale tatimore dhe DPT për fillimin e

procedimit disiplinor dhe marrjen e masave administrative ndaj punonjësve të administratës tatimore, të cilët kanë shkelur dispozitat e Kodit të Etikës;

e) i referon raste të veçanta DPT-së, konkretisht Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm ose Drejtorisë së Hetimit Tatimor, nëse informacioni apo dokumentacioni i nxjerrë tregojnë se rasti në fjalë kërkon nisjen e procesit të hetimit administrativ ose dhe penal ndaj personit apo personave përgjegjës, që me veprimet apo mosveprimet e tyre kanë shkelur të drejtat e tatimpaguesit;

ë) i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve propozime për përmirësime në proceset e punës dhe në procedurat tatimore, si dhe lidhur me dispozitat e Kodit të Etikës, me synim përmirësimin e shërbimeve ndaj tatimpaguesve, reduktimin e barrës administrative dhe lehtësimin e procedurave për tatimpaguesit në përmbushje të detyrimeve tatimore;

f) nxjerr rekomandime me karakter të përgjithshëm në lidhje me çështjet e identifikuar gjatë ushtrimit të funksioneve të tij dhe i përdor ato si bazë për të bërë propozime për ndryshimin e legjislacionit përkatës;

g) nxjerr rekomandime me shkrim drejtuar Drejtorisë së Apelit Tatimor ose Komisionit për Shqyrtimin e Apeliteve Tatimore dhe/ose i paraqet këto rekomandime në seancat dëgjimore administrative të mbajtura nga Drejtoria e Apelit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apeliteve Tatimore;

gj) kryen monitorime periodike, për të verifikuar me anë të sondazheve përmbushjen e procesit të informimit dhe të shërbimit ndaj tatimpaguesve, në përputhje me dispozitat ligjore, rregullat dhe rregulloret e miratuara.

3.2 Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesve ka si funksion parësor sigurimin e një informacioni eficient dhe prezantimin në hallkat administrative përkatëse të problemeve e të shqetësimeve të tatimpaguesve, në përmbushjen e detyrimeve tatimore dhe të procedurave përkatëse administrative, si dhe garantimin e plotësisë së të drejtave të tatimpaguesve nga administrata tatimore.

3.3 Avokati i Tatimpaguesve gëzon të drejtën e njohjes dhe marrjes me shkrim nga strukturat e administratës tatimore të çdo informacioni të



përgjithshëm apo të veçantë për një tatimpagues apo një grup tatimpaguesish, në çdo fazë të procesit administrativ të nisur prej tij. Ai mund të kërkojë informacion pranë çdo strukture të administratës tatimore, përfshirë Drejtorinë e Hetimit Tatimor, për aq sa nuk cenohen interesat e hetimit tatimor, siç përcaktohet në dispozitat ligjore në fuqi për këtë qëllim. Avokati i Tatimpaguesve gëzon të drejtën e njohjes dhe marrjes së informacionit edhe nga strukturat përkatëse të shqyrtimit administrativ tatimor në Ministrinë e Financave.

3.4 Avokati i Tatimpaguesve, në bazë të kërkesës së tatimpaguesit, ka të drejtë t'i rekomandojë Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nxjerrjen e vendimeve teknike, në përputhje me përcaktimet e nenit 10 të ligjit për procedurat tatimore. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve në çdo rast i kthen përgjigje të arsyetuar Avokatit të Tatimpaguesve, për marrjen parasysh ose jo të rekomandimit brenda një afati 30-ditor.

3.5 Avokati i Tatimpaguesve nuk është i autorizuar të hetojë apo të ndërhyjë në rastet, për të cilat tatimpaguesi është hetuar nga Drejtoria e Hetimit Tatimor apo nga Drejtoria e Investigimit të Brendshëm. Avokati i Tatimpaguesve nuk autorizohet të investigojë apo të ndërhyjë në procesin e përcaktimit të detyrimit tatimor apo për raste, të cilat janë në proces.

3.6 Avokati i Tatimpaguesve është i autorizuar të hetojë dhe të ndërhyjë, nëse procesi i vlerësimit të detyrimeve tatimore apo procesi i apelimit nuk kryhet në përputhje me procedurat e vendosura në ligj apo në dispozitat përkatëse nënligjore. Në çdo rast, ky autorizim kufizohet me të drejtën e sigurimit të respektimit të procedurave dhe jo në vendimet lidhur me shumat e vlerësuara të detyrimeve tatimore apo në vendimin e marrë për apelimin.

3.7 Autoriteti i Avokatit të Tatimpaguesve

3.7.1 Avokati i Tatimpaguesit është një garanci shtesë për mbrojtjen e sigurimin e të drejtave dhe interesave të ligjshëm të tatimpaguesve nga ana e administratës tatimore.

3.7.2 Avokati i Tatimpaguesve monitoron procedurat administrative në veprimtarinë tatimore dhe heton pretendimet për veprime të papërshtatshme ose mungesën e veprimeve nga autoritetet tatimore, në bazë të ankesave të paraqitura ose me iniciativën e tij.

3.7.3 Avokati i Tatimpaguesve kryen detyra që lidhen me mbrojtjen e tatimpaguesve nga veprime të papërshtatshme të autoriteteve tatimore ose mosveprimi i atyre, si rezultat i të cilave preken e cenohen të drejtat dhe interesat e ligjshme të tatimpaguesve.

3.7.4. Avokati i Tatimpaguesve ndjek me përgjegjësi e përkushtim çdo rast të mbërritur në adresë të tij dhe synon marrëveshje me administratën tatimore, përkatësisht drejtoritë rajonale ose drejtoritë funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, masat që duhen marrë dhe procedurat që duhet të ndiqen për zgjidhjen e rasteve të paraqitura.

3.7.5 Avokati i Tatimpaguesve monitoron dhe heton vetëm procedurën e përcaktuar në ligj apo akte nënligjore dhe nuk ka kompetencë të shqyrtojë raste që kanë të bëjnë me përcaktimin e detyrimit tatimor apo raste që janë në proces apelimi.

3.7.6 Avokati i Tatimpaguesve nuk është i autorizuar të shqyrtojë çështje që janë subjekt i juridiksionit të drejtorive të investigimit të brendshëm dhe të hetimit tatimor, por mund të bashkëpunojë me këto struktura, në rast se vihet në dijeni të rasteve që janë objekt i punës së tyre. Në këto raste, Avokati i Tatimpaguesve mund të marrë informacion për aq sa nuk cenohen interesat e hetimit.

3.7.7 Avokati i Tatimpaguesve nuk është hallkë e rishikimit administrativ tatimor dhe as nuk e zëvendëson atë. Të kontaktosh Avokatin e Tatimpaguesit për asistencë nuk e pezullon afatin kohor, brenda të cilit mund të paraqitet një apelim. Në rast konstatimi të shkeljeve të të drejtave të tatimpaguesve nga ana e administratës tatimore lidhur me zbatimin e afateve dhe procedurat, që u pengojnë, vonojnë apo mohojnë të drejtën e apelimit, Avokati i Tatimpaguesve, pasi konstaton rastin pas ankimit të tatimpaguesit, ka autoritetin të kërkojë rivendosjen në afat, në përputhje me dispozitat e përcaktuara për këtë qëllim në Kodin Civil dhe Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

3.7.8 Avokati i Tatimpaguesve nuk ka të drejtë të shprehet në lidhje me themelin e një çështjeje administrative tatimore, përveçse për procedurë, e cila është në proces hetimi apo apelimi e për rrjedhojë do të përfundojë me një vlerësim tatimor apo vendim nga Drejtoria e Apelit Tatimor.



3.7.9 Në marrëdhëniet me tatimpaguesit dhe në mbrojtje të të drejtave të tyre, në zbatim të legjislacionit tatimor dhe për më shumë transparencë dhe përgjegjshmëri nga ana e organit tatimor, Avokati i Tatimpaguesve monitoron procedurat e ndjekura nga administrata tatimore në procesin e administrimit tatimor dhe marrëdhënies së administratës tatimore me tatimpaguesit.

3.7.10 Avokati i Tatimpaguesve merr pjesë, është i ftuar dhe është aktiv në të gjitha diskutimet për ndryshimet në proceset e punës dhe procedurat e deklarimit, vlerësimit, mbledhjes, kontrollit dhe investigimit tatimor dhe përfaqëson në këto takime interesat e tatimpaguesve. Strukturat drejtuese të administratës tatimore duhet ta përfshijnë atë si pjesëmarrës në diskutimet/takimet/analizat që kanë të bëjnë me politikën, nismat e reja dhe prioritetet e zhvillimit të programit të menaxhimit të të ardhurave tatimore.

3.7.11 Avokati i Tatimpaguesve merr pjesë edhe në forumet dhe organizimet e biznesit për çështje që lidhen me aspektet e administrimit tatimor, madje edhe duhet të iniciojë takime me bizneset për diskutimin e situatave të cilat kanë të bëjnë me probleme të procedurave të administrimit të tatimeve.

3.7.12 Avokati i Tatimpaguesve gëzon liri të plotë e të menjëhershme tek informacioni dhe dokumentacioni i disponuar dhe administruar nga administrata tatimore në të gjitha nivelet, për çështjet që ai ka nisur hetimin administrativ.

3.7.13 Avokati i Tatimpaguesve ka autoritet të kërkojë informacion dhe sqarime nga të gjithë punonjësit e administratës tatimore, kur informacioni i kërkuar lidhet me një çështje të caktuar dhe për të cilën është nisur një hetim administrativ prej tij.

3.7.14 Avokati i Tatimpaguesve ka autoritetin të urdhërojë:

a) *Urdhri i çështjes*: drejtoritë rajonale tatimore për kryerjen e verifikimeve dhe hetimeve, lidhur me ankesa të veçanta që i paraqiten Avokatit të Tatimpaguesit. Brenda 30 ditëve, drejtori rajonal tatimor duhet të informojë Avokatin e Tatimpaguesve se ai e ka zgjidhur problemin ose t'i kërkojë Avokatit që të bjerë dakord se provat e disponueshme tregojnë se kërkesa e tatimpaguesit për t'u çliruar nga hetimi, është pa vend.

b) *Urdhri i procedurës*: drejtoritë funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve duhet të

shqyrtojnë procedurat ekzistuese, të cilat mund të jenë duke shkaktuar probleme të pajustificueshme për tatimpaguesit. Brenda 30 ditëve, drejtorët funksionalë duhet të informojnë Avokatin, nëse ata e kanë ndryshuar procedurën ose t'i kërkojnë atij të bjerë dakord se ndryshimi nuk është i nevojshëm.

c) Në të dyja rastet këta urdhra nuk pezullojnë procedurat e shqyrtimit nga ana e drejtorive rajonale apo drejtorive funksionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për çështjet që janë objekt i ankimit, kërkesës apo njoftimit dhe as procedurën e ekzekutimit të akteve që kanë dalë nga administrata tatimore për ato çështje.

3.7.15 Shkresat (urdhurat), opinionet dhe rekomandimet e nxjerra nga Avokati i Tatimpaguesve, duhet të trajtohen me përgjegjësi nga hallkat përkatëse të administratës tatimore dhe të gjejnë përgjigje.

3.7.16 Në rast se Avokati i Tatimpaguesve dhe një drejtor rajonal ose funksional nuk bien dakord për zgjidhjen e një problemi ose për ndryshimin e një procedure, atëherë Avokati, si përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për financat, duhet ta udhëzojë drejtorin rajonal që t'ia referojë çështjen zëvendës drejtorit të përgjithshëm të tatimeve për shqyrtim dhe rishikim. Zëvendës drejtori i përgjithshëm duhet të konsultohet fillimisht me Avokatin dhe më pas duhet t'i përgjigjet atij brenda shtatë ditëve pune, lidhur me vendimin e tij.

3.7.17 Nëse zëvendës drejtori i përgjithshëm dhe Avokati i Tatimpaguesve nuk bien dakord për sa i përket një ankese për një çështje tatimore apo procedurale, Avokati do të jetë përgjegjës që të planifikojë një takim për diskutimin dhe shqyrtimin e çështjes me Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve, i cili merr vendimin përfundimtar. Asnjë nga palët nuk duhet të takohet me Drejtorin e Përgjithshëm në veçanti për të diskutuar pozicionin e tyre, kur pala tjetër mungon.

3.7.18 Avokati i Tatimpaguesve bën analizimin e rasteve dhe rekomandon aplikimin e procedurave të unifikuara për aspekte të caktuara të administrimit tatimor me qëllim parandalimin e praktikave të kundërshtuara nga tatimpaguesit.

3.7.19 Sipas ligjit, Avokati i Tatimpaguesve ka të drejtë të propozojë masa disiplinore për punonjësit e administratës tatimore që, nga analizimi i rasteve të procesuara prej tij, rezulton se kanë kryer veprime me dashje për të dëmtuar



një tatimpagues apo të shkelin ligjin ose procedurat. Por, para se ta kryejë këtë gjë, Avokati i Tatimpaguesve duhet t'i paraqesë provat dhe faktet e konstatuara prej tij përpara Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, si eprori më i lartë drejtues dhe ta inkurajojë atë që të ndër marrë veprimet e nevojshme.

3.7.20 Avokati i Tatimpaguesve ka kompetencë të rekomandojë masa korrigjuese dhe po të jetë rasti, edhe ndryshime në legjislacionin tatimor apo Kodin e Etikës së Administratës Tatimore.

3.7.21 Kur gjatë procesit të hetimit administrativ të nisur nga Avokati i Tatimpaguesve për çështje të veçanta, Avokatit të Tatimpaguesit nuk i jepet informacioni i kërkuar nga individë të veçantë apo autoriteti tatimor të cilit i është drejtuar, apo nuk i vihet në dispozicion dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e provave dhe të fakteve që lidhen me çështjen e nisur, Avokati i Tatimpaguesve ka të drejtën të propozojë menjëherë fillimin e procedurës disiplinore ndaj personit apo personave pengues. Kur një veprim i tillë pengues nga individë të veçantë përbën vepër penale, ai mund të kërkojë edhe fillimin e procedimit penal për pengim të hetimit administrativ.

#### 4. Rregullat dhe procedurat për shqyrtimin e çështjeve

4.1 Çdo tatimpagues, grup tatimpaguesish, shoqata apo institucione që mbrojnë interesat e tatimpaguesve, pretendojnë për shkelje të të drejtave dhe të interesave të të ligjshme, qofshin këto individuale apo të përbashkëta të tatimpaguesit apo tatimpaguesve, me veprime të paligjshme apo të parregullta të administratës tatimore qendrore ose me mosveprime të saj, kanë të drejtë të ankohen ose të njoftojnë Avokatin e Tatimpaguesve dhe të kërkojnë ndërhyrjen e tij për rregullimin e situatës, në lidhje me një të drejtë të shkelur apo të mohuar.

4.2 Për ankesat, kërkesat dhe njoftimet drejtuar Avokatit të Tatimpaguesit nuk kërkohet ndonjë formë apo format i caktuar. Ato duhet të shprehin qartë objektin e ankimit ose të kërkesës. Nëse disponohen, dokumente, fakte dhe prova, të cilat mendohet se mbështesin objektin e ankimit, ato duhet t'i bashkëngjiten ankesës së drejtuar Avokatit të Tatimpaguesve.

4.3 E drejta për t'u ankuar tek Avokati i Tatimpaguesve lind vetëm pasi të jetë konsumuar një herë me shkrim e drejta për t'u ankuar te drejtoria rajonale përkatëse apo drejtoritë funksionale brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të cilat kanë nën juridiksion shqyrtimin/administrimin e procedurës së kontestuar nga ankimuesi.

4.4 Nëse tatimpaguesi ankues/kërkues nuk ka marrë përgjigje apo zgjidhje nga hallka e parë brenda 30 ditëve nga dita e depozitimit të shkresës kërkuese, mund t'i kërkojë apo të njoftojë me shkrim Avokatin e Tatimpaguesve, në lidhje me procedurën të cilën konteston dhe pretendon që shkel të drejtat apo interesat e tij. Dita e depozitimit të kërkesës në organin tatimor do të konsiderohet:

a) Dita e dhjetë pas nisjes së kërkesës me rrugë postare, duke filluar nga dita e dorëzimit të saj në zyrën e shërbimit postar;

b) Dita e konfirmimit të marrjes dorazi të kërkesës nga zyra e protokollit përkatës në drejtorinë rajonale tatimore apo Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, kur kërkesa dorëzohet dorazi nga tatimpaguesi apo grupi i tatimpaguesve;

c) Dita e dërgimit të kërkesës me postë elektronike (*email*), në rast se kërkesa dërgohet në rrugë elektronike. Në këtë rast, kërkesa duhet të niset në adresën elektronike përkatëse të kontakteve, të njoftuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve apo të drejtorisë rajonale tatimore.

4.5 Avokati i Tatimpaguesve, pasi i mbërrin ankesa, kërkesa apo njoftimi për një shkelje apo procedurë të kontestuar, e protokollon atë në një regjistër të veçantë të administruar nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesve.

4.6 Regjistrimi i veçantë i shkresave të mbërritura në adresë të Avokatit të Tatimpaguesve bëhet me qëllim të lehtësimit të procedurave të mbërritjes së ankesave apo njoftimeve, si edhe me qëllim analizimin e rasteve të njoftuara në atë drejtori.

4.7 Shkresat e procesuara nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesve firmosen nga Avokati i Tatimpaguesve dhe mbajnë vulën e Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesit, ku veç shënimit të termit të ministrisë përgjegjëse për financat, vendoset dhe shënimi "Avokati i Tatimpaguesve".

Vula e Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesve përdoret vetëm për korrespondencën shkresore të



kësaj drejtorie me tatimpaguesit, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe organeve tatimore, si dhe me institucione apo organe qendrore, kur korrespondenca shkresore lidhet vetëm me zbatimin e detyrave të kësaj drejtorie.

4.8 Pasi njihet me ankesën, kërkesën apo njoftimin për një shkelje, Avokati i Tatimpaguesve vendos:

- a) të pranojë çështjen për shqyrtim;
- b) të mos pranojë çështjen për shqyrtim.

4.9 Në rast të mosfillimit të shqyrtimit të një çështjeje nga ana e Avokatit të Tatimpaguesit për një nga arsyet që e përligjin mosfillimin, ky vendim duhet t'i njoftohet kërkuarit së bashku me arsyen brenda 5 (pesë) ditëve nga regjistrimi i çështjes. Nëse gjatë shqyrtimit të ankesës, vërehet se çështja nuk mund të shqyrtohet për shkak të mos shoqërimit me dokumente, prova apo fakte, të cilat bëhen të ditura në ankesën drejtuar Avokatit të Tatimpaguesve, por që nuk i janë të bashkëngjitura ankesës, në shkresën e mospranimit të ankesës, Avokati i Tatimpaguesve i kërkon ankimesit të plotësojë ankesën e tij edhe me këto prova apo fakte, që pretendohet se janë, me qëllim rimarrjen në shqyrtim të ankesës.

Për përsheptimin e rishqyrtimit të ankesës, një komunikim i tillë mund të bëhet edhe në rrugë elektronike apo dhe telefonike, nëse ankimesi ka dhënë edhe adresë kontakti në ankimesin e tij.

Vetëm kur çështja e ankimesit nuk përbën objekt shqyrtimi nga Avokati i Tatimpaguesve, vendimi për refuzimin bëhet me shkrim, ku sqarohet edhe arsyeja, apo argumentet se përse çështja nuk mund të shqyrtohet nga Avokati i Tatimpaguesve. Kjo nuk e pengon Avokatin e Tatimpaguesve, kur është e mundur, në përgjigjen e tij të japë dhe rekomandime lidhur me procedimin e mëtejshëm nga ankimesi për të kërkuar zgjidhjen e çështjes së ngritur prej tij.

Vendimi i Avokatit për mosfillimin e çështjes nuk apelohehet, por mund t'i drejtohet një drejtuesi më të lartë për t'u rishikuar.

4.10 Avokati i Tatimpaguesve e fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar.

Avokati i Tatimpaguesve ka autoritetin të nisë me vetinisativë një çështje, për raste të veçanta kur ato bëhen publike, apo kur vihet në dijeni se ka

ndodhur një shkelje, e cila është në objektin e punës së tij.

4.11 Në rast të plotësimit të kushteve për pranimin e ankesës apo kërkesës, Avokati i Tatimpaguesve njofton të interesuarit, duke u kthyer përgjigje me shkrim, me e-mail apo telefon, brenda 10 ditëve nga dita e regjistrimit të ankesës, kërkesës ose njoftimit dhe, sipas rastit, e njofton tatimpaguesin se ka nisur një procedurë hetimore që mund të zgjasë më shumë.

Nëse e gjykon të nevojshme, Avokati i Tatimpaguesve mund ta thërrasë ankimesin në takim, për të dëgjuar pretendimet e tij, si dhe për të kërkuar më tepër shpjegime lidhur me çështjen për të cilën ankimesi. Në rast të tillë mbahen shënimet përkatëse, të cilat përfshihen në dosjen e hapur për shqyrtimin e çështjes së ankimesit. Në shënimet përkatëse shënohet data dhe ora, kur është zhvilluar takimi me ankimesin. Në këtë rast, tatimpaguesi mund të thirret për t'u dëgjuar në çdo periudhë kohore brenda shqyrtimit të çështjes së ankimesit prej tij. Nëse është e nevojshme, tatimpaguesi mund të thirret përsëri për të dëshmuar pretendimet e tij lidhur me çështjen në shqyrtim, përpara afatit të marrjes së vendimit nga Avokati i Tatimpaguesve për të mbyllur hetimin administrativ dhe mbylljes së dosjes.

4.12 Në rastet kur ankesa apo kërkesa kërkon zhvillimin e një verifikimi apo hetimi nga një drejtori tatimore rajonale, Avokati i Tatimpaguesve, jo më vonë se 15 ditë nga data e regjistrimit të ankesës, i dërgon drejtorisë përkatëse rajonale tatimore një shkresë (urdhër për rishikim praktike), në të cilën jepen të dhëna të sakta identifikuese të ankimesit, përfshirë problemet që duhet të verifikohen apo zgjidhen, duke vënë dhe afate konkrete për kryerjen e verifikimeve apo zgjidhjen e problemeve. “Urdhri për rishikimin e një praktike”, i lëshuar nga Avokati i Tatimpaguesve për drejtorinë rajonale tatimore përkatëse, do të ketë formën sipas modelit nr. 1, bashkëngjitur. Avokati i Tatimpaguesve vendos nëse duhet t'i bashkëngjisë ose jo “Urdhrit për rishikimin e një praktike”, kopje të ankesës apo dokumentacionit shtesë të paraqitur nga ankimesi.

4.13 Drejtoria rajonale tatimore duhet të kryejë hetimet e nevojshme dhe të njoftojë me shkrim Drejtorinë e Avokatit të Tatimpaguesit, jo më vonë se 30 ditë nga data e marrjes së shkresës (urdhrit) nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit. Në





përgjigjen me shkrim, drejtorja rajonale tatimore duhet të shprehë qëndrimin e saj lidhur me zgjidhjen ose jo të rastit të ankimuar, duke dhënë dhe argumente, si dhe, nëse shihet e nevojshme, të shoqëruar me dokumentacion provues mbi qëndrimin e saj, kur nuk është dakord me pretendimin mbi ankimin e tatimpaguesit, apo kur nuk jepet dot zgjidhje prej saj.

4.14 Në rast se Avokati i Tatimpaguesve dhe një drejtor rajonal nuk bien dakord për zgjidhjen e duhur të një “Urdhri rishikimi praktike”, Avokati i Tatimpaguesve dhe drejtori rajonal do t’ia paraqesin rastin zëvendësdrejtorit të përgjithshëm që mbulon drejtorinë rajonale në fjalë.

Zëvendësdrejtorit të përgjithshëm i vihen në dispozicion shkresërisht, përveç ankesës së tatimpaguesit edhe të gjitha provat, faktet dhe dokumentet e mbledhura, mbi të cilat shkrehen qëndrimet e Avokatit të Tatimpaguesve dhe drejtuesit të drejtorisë rajonale përkatëse.

4.15 Në rast se Avokati i Tatimpaguesve dhe zëvendësdrejtori i përgjithshëm territorial përkatës nuk bien dakord për zgjidhjen e duhur të një “Urdhri rishikimi praktike”, rasti i paraqitet Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, së bashku me të gjitha provat, faktet dhe qëndrimet gjatë shqyrtimit të rastit të ankimuar. Avokati i Tatimpaguesve, në varësi të fakteve, provave dhe qëndrimit të tij, mund të shprehë edhe rekomandimet e veta lidhur me gjetjet dhe zgjidhjen e çështjes.

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, pasi shqyrton çështjen e ankimuar, si dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe qëndrimin e shprehur nga Avokati i Tatimpaguesve, Zëvendësdrejtori i përgjithshëm dhe drejtorja rajonale tatimore, shprehet zyrtarisht me qëndrimin e tij mbi ankesën a tatimpaguesit.

Qëndrimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve i bëhet i ditur zyrtarisht tatimpaguesit që ka bërë ankesën, brenda 15 ditëve nga marrja e përgjigjes zyrtare. Në rast se çështja e ankimuar nuk merr zgjidhje nga administrata tatimore, por për zgjidhjen e saj është e nevojshme shqyrtimi në rrugë gjyqësore, Avokati i Tatimpaguesve i rekomandon tatimpaguesit të ndjekë rrugën e zgjidhjes nëpërmjet ankimit në gjykatën administrative.

4.16 Në rastet kur një ankesë lidhet me një procedurë tatimore që duhet të trajtohet nga një

drejtori funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Avokati i Tatimpaguesve përgatit një shkresë (urdhër rishikimi procedural) që i drejtohet drejtorisë përkatëse funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Urdhri i rishikimit procedural do të hartohet sipas modelit nr. 2 bashkëngjitur.

4.17 Drejtorja funksionale përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve duhet t’i përgjigjet Avokatit të Tatimpaguesit brenda 15 ditëve nga data e marrjes së urdhrin për rishikim procedural.

4.18 Nëse Avokati i Tatimpaguesve dhe një drejtor funksional në DPT nuk bien dakord për zgjidhjen e duhur të një “Urdhri për rishikim të një procedure”, Avokati i Tatimpaguesve dhe drejtori funksional do t’ia paraqesin rastin zëvendësdrejtorit të përgjithshëm që mbulon drejtorinë funksionale përkatëse.

Zëvendësdrejtorit të përgjithshëm i vihen në dispozicion shkresërisht, përveç ankesës së tatimpaguesit edhe të gjitha provat, faktet dhe dokumentet e mbledhura, mbi të cilat shkrehen qëndrimet e Avokatit të Tatimpaguesve dhe të drejtorisë përkatëse në DPT.

4.19 Në rast se Avokati i Tatimpaguesve dhe zëvendësdrejtori i përgjithshëm funksional nuk bien dakord për zgjidhjen e duhur të një “Urdhri për rishikim procedure”, rasti i paraqitet Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, së bashku me të gjitha provat, faktet dhe qëndrimet gjatë shqyrtimit të rastit të ankimuar. Avokati i Tatimpaguesve, në varësi të fakteve, provave dhe qëndrimit të tij, mund të shprehë edhe rekomandimet e veta lidhur me gjetjet dhe zgjidhjen e çështjes.

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, pasi shqyrton çështjen e ankimuar, si dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe qëndrimin e shprehur nga Avokati i Tatimpaguesve, Zëvendësdrejtori i përgjithshëm dhe drejtorja përkatëse në DPT, shprehet zyrtarisht me qëndrimin e tij mbi ankesën a tatimpaguesit.

Qëndrimi i Drejtorit të Përgjithshëm i bëhet i ditur zyrtarisht tatimpaguesit që ka bërë ankesën, brenda 15 ditëve nga marrja e përgjigjes zyrtare. Në rast se çështja e ankimuar nuk merr zgjidhje nga administrata tatimore, por për zgjidhjen e saj është e nevojshme shqyrtimi në rrugë gjyqësore, Avokati i Tatimpaguesve i rekomandon



tatimpaguesit të ndjekë rrugën e zgjidhjes nëpërmjet ankimimit në gjykatën administrative.

4.20 Avokati i Tatimpaguesve duhet të ruajë konfidencialitetin për informacionin e dhënë nga ankimuesi, duke mos e paraqitur atë të plotë te drejtoria rajonale me të cilën lidhet ankimimi, për sa e gjykon të arsyeshme, si dhe nëse kjo kërkohet nga personi që bën ankesën, kërkesën apo njoftimin.

4.21 Me përfundimin e procedurës së rishqyrtimit, jo më vonë se 15 ditë nga data e përfundimit të rishqyrtimit, Avokati i Tatimpaguesve bën njoftimin e ankimuesit nëpërmjet një opinionimi përmbledhës me rezultatet e rishqyrtimit dhe mbyll praktikën duke bërë edhe arkivimin e saj. Nëse tatimpaguesi është i kënaqur nga zgjidhja e çështjes, ky njoftim mbylljeje mund të bëhet dhe me gojë. Data dhe ora e njoftimit me gojë duhet të regjistrohet në kopjen e urdhrin të mbylljes që ndodhet në zyrën e Avokatit.

4.22 Administrimi i kërkesave, njoftimeve apo ankesave të mbërritura tek Avokati i Tatimpaguesve bëhet nëpërmjet një programi kompjuterik, i cili në çdo kohë mund të japë informacion në lidhje me ankuesin, objektin e ankimit, ecurinë e trajtimit nga Avokati i Tatimpaguesve, që nga marrja në shqyrtim e deri te mbyllja e çështjes me shënimet përkatëse të arsyeve dhe rezultateve të mbylljes.

4.23 Në asnjë rast ankimi, kërkesa apo njoftimi i depozituar pranë Avokatit të Tatimpaguesit nuk e pezullon procedurën e shqyrtimit nga ana e drejtorive rajonale apo drejtorive funksionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për çështjet që janë objekt i ankimit, kërkesës apo njoftimit dhe as procedurën e ekzekutimit të akteve që kanë dalë nga administrata tatimore për ato çështje.

4.24 Çdo shërbim që ofrohet nga Avokati i Tatimpaguesve është pa pagesë.

## 5. Raportimi

5.1 Avokati i Tatimpaguesve raporton periodikisht te drejtori i përgjithshëm në ministri që e ka në varësi hierarkike, si dhe çdo tre muaj Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë dhe ministri përgjegjës për financat. Një kopje të raportit, Avokati i Tatimpaguesit ia dërgon dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

5.2 Përveç raportimit të zakonshëm, Avokati i Tatimpaguesve i raporton eprorëve të hierarkisë dhe ministrit përgjegjës për financat, sa herë që i kërkohet prej tyre.

5.3 Në rastet kur e gjykon të arsyeshme, Avokati i Tatimpaguesve ka të drejtë të kërkojë të raportojë tek eprorët e hierarkisë funksionale dhe ministri përgjegjës për financat për situata apo çështje të veçanta, përveç raportimit periodik.

5.4 Raportimi i Avokatit të Tatimpaguesve duhet të përfshijë:

5.4.1 Të dhëna cilësore lidhur me:

i) Numrin e ankesave të marra, të pranuar për investigim që lidhen me çështjet dhe numrin e atyre të refuzuara. Numrin e çështjeve të mbyllura. Numrin e çështjeve që mbeten të hapura dhe përqindjen e atyre që janë të vjetra. Numrin e çështjeve për të cilin ankesa e tatimpaguesit është përcaktuar e pavlefshme. Numri i çështjeve të mbyllura, ku vendimi ka qenë në favor të tatimpaguesit dhe volumi i çështjeve sipas funksionit, do të raportohen gjithashtu;

ii) Numri i urdhrave proceduralë për shqyrtim që janë lëshuar, mbyllur, mbeten të hapur, si dhe përqindja e urdhrave të vjetër. Numri i urdhrave të mbyllur proceduralë për shqyrtim, ku vendimi përfundimtar është mbështetur nga rekomandimi i Avokatit të Tatimpaguesit;

iii) Numri i herëve që Avokati i Tatimpaguesve dhe zëvendës drejtori i përgjithshëm kanë rishikuar një rast të shqyrtuar apo një urdhr të ndryshuar dhe kanë arritur apo jo në një marrëveshje;

iv) Për raportin tremujor që i drejtohet Ministrisë së Financave, raporti duhet të përcaktojë numrin e herëve që Drejtorit të Përgjithshëm i është kërkuar të japë një vendim përfundimtar deri në atë masë sa rezultati është mbështetur nga pozicioni i zëvendës drejtorit të përgjithshëm apo ai i Avokatit.

5.4.2 Problematika dhe çështje që lidhen me politikat e administrimit:

i) Përshkrim të problemeve që hasen më shpesh, shkaqet e tyre dhe veprimet e nevojshme për të pakësuar problem të ngjashme në të ardhmen.

ii) Raporti do të identifikojë gjithashtu çështje të ligjit dhe politikës që rritin përgjegjësinë ndaj tatimpaguesve, të cilët tentojnë të përmbushin vullnetarisht detyrimet tatimore.

5.5 Raportet përshkruajnë takime dhe forume në sektorin privat, ku Avokati i Tatimpaguesve apo personeli i tij kanë bërë prezantime dhe kanë kërkuar opinionin e tatimpaguesve.



5.6 Raporti do t'i paraqitet Sekretarit të Përgjithshëm dhe ministrit përgjegjës për financat brenda datës 20 të muajit që pason çdo tremujor në kalendar.

5.7 Në fund të çdo viti, por jo më vonë se data 31 janar e vitit pasues, Avokati i Tatimpaguesve harton dhe paraqet përpara ministrit përgjegjës për financat raportin vjetor të punës njëvjeçare, lidhur me rastet e trajtuara, evidentimet e problematikave, rezultatet e arritura, si dhe për rekomandimet e dhëna.

5.8 Avokati i Tatimpaguesve ndërton dhe faqen e vet elektronike në *website* të ministrisë përgjegjëse për financat, me qëllim promovimin e punës dhe

problematicave që ndjek si institucion në mbrojtje të të drejtave të tatimpaguesve.

#### 6. Shfuqizime

Udhëzimi nr. 37, datë 5.11.2010, shfuqizohet.

#### 7. Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin e tij në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1 Janari 2019.

MINISTRI I FINANCAVE  
DHE EKONOMISË  
**Anila Denaj**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

### AVOKATI I TATIMPAGUESVE

Nr. \_\_\_\_\_/\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.201\_\_

**Lënda:** Urdhër për rishikim praktike

#### DREJTORISË RAJONALE TATIMORE .....

*Adresa: Rruga ".....", .....*

I nderuar Z./Znj.....

Avokati i Tatimpaguesve po shqyrton ankesën e tatimpaguesit ..... me NIPT/NUIS..... lidhur me problemin .....

Bazuar në dispozitat e udhëzimit nr....., të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, datë ..... "Për funksionet, përgjegjësitë dhe procedurat që do të zbatohen nga Avokati i Tatimpaguesve dhe procedurat që do të ndiqen nga tatimpaguesit, urdhëroj kryerjen e verifikimeve të nevojshme dhe shqyrtimin e problemit që vijon:

Përshkrimi i ankesës: .....

.....

.....

.....

Për sa më sipër, bazuar në dispozitat e udhëzimit të sipërpërmendur, lutemi na dërgoni rezultatet e shqyrtimit të praktikës brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e këtij urdhri.

Ju faleminderit!

**AVOKAT I TATIMPAGUESVE**

.....

*Konceptoi:* .....

*Datë:* .....



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

## AVOKATI I TATIMPAGUESVE

Nr. \_\_\_\_\_/\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.201\_\_

Lënda: Urdhër për rishikim procedural

## DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

DREJTORISË SË .....

*Adresa: Rruga "Gjin Bue Shpata", TIRANË*

I nderuar Z./Znj. ....

Avokati i Tatimpaguesve po shqyrton ankesën e tatimpaguesit ..... me NIPT/NUIS....., ose ankesën e institutit, shoqatës/përfaqësisë së tatimpaguesve etj., lidhur me problemin.....

Bazuar në dispozitat e udhëzimit nr. .... të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, datë ..... "Për funksionet, përgjegjësitë dhe procedurat që do të zbatohen nga Avokati i Tatimpaguesve dhe procedurat që do të ndiqen nga tatimpaguesit, urdhëroj rishikimin e procedurës:

.....  
 .....  
 .....

Bashkëngjitur janë fakte dhe argumente lidhur me këtë ndryshim.

Për sa më sipër, bazuar në dispozitat e udhëzimit të sipërpërmendur, lutemi na dërgoni rezultatet e shqyrtimit të praktikës brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e këtij urdhri.

Ju faleminderit!

AVOKAT I TATIMPAGUESVE

.....

Konceptoi: .....

Datë: .....

**VENDIM**

Nr. 4, datë 11.3.2019

**PËR PROCEDURËN E VERIFIKIMIT  
TË KANDIDATËVE PËR POZICIONET  
VAKANTE NË GJYKATËN  
KUSHTETUESE DHE TË INSPEKTORIT  
TË LARTË TË DREJTËSISË**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 229, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

**VENDOSI:****I. Dispozita të përgjithshme**

1. Ky vendim përcakton rregulla më të hollësishme lidhur me procedurat që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (*Këshilli*) zhvillon për verifikimin e pasurisë, integritetit, të shkuarës profesionale dhe personale, si edhe të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore që duhet të plotësojnë kandidatët për t’u zgjedhur në pozicionet vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për inspektorë të lartë të drejtësisë.

2. Përcaktimi në këtë vendim i rregullave më të hollësishme mbi procedurat e verifikimit të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe inspektorë të lartë të drejtësisë kanë për qëllim realizimin e kësaj procedure duke u bazuar në meritat e kandidatëve dhe duke respektuar procesin e rregullt ligjor, si edhe parimet e përgjithshme të procedurës administrative, veçanërisht ato të ligjshmërisë, transparencës, informimit, të drejtësisë, të paanësisë, të mbrojtjes së të dhënave, konfidencialitetit e të sekretit shtetëror.

**II. Rregulla të përgjithshme të procedurës së verifikimit**

A. Fillimi dhe fazat e procedurës së verifikimit

3. Procedura administrative e verifikimit të kandidatëve fillon në ditën e zhvillimit të mbledhjes së Këshillit. Mbledhja zhvillohet brenda 5 ditëve nga publikimi i listës së kandidatëve për pozicionin vakant në Gjykatën Kushtetuese nga subjektet që vënë në lëvizje Këshillin e Emërimeve në Drejtësi ose nga publikimi i listës së kandidatëve për pozicionin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nga ana e këtij Këshilli.

4. Në të njëjtën ditë të mbledhjes së Këshillit zhvillohet edhe procedura e shortit për caktimin, ndërmjet anëtarëve të Këshillit, të relatorit për secilin pozicion vakant në çdo institucion. Në çdo

rast, procedura e shortit zhvillohet brenda afatit 5-ditor të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi.

5. Procedura administrative e verifikimit të kandidatëve realizohet në dy faza:

a) veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit;

b) shqyrtimi dhe miratimi i projektaktit të verifikimit nga Këshilli.

B. Të drejtat e kandidatit

6. Kandidati ka të drejtë që, në çdo fazë të procedurës së verifikimit, me kërkesën e tij, të njihet me dokumentet e dosjes së kandidimit dhe aktet procedurale të kryera nga relatori dhe Këshilli për verifikimin e kandidaturës, si edhe të marrë kopje të tyre, sipas rregullave të Kodit të Procedurave Administrative dhe atyre të përcaktuara në këtë vendim.

7. Kryesisht apo mbi kërkesën e Këshillit, kandidati ka të drejtë të paraqesë shpjegime me shkrim për faktet, rrethanat apo çështjet ligjore të lidhura me kandidimin e tij/saj, si dhe të depozitojë dokumente shkresore shtesë, në mbështetje të këtyre shpjegimeve.

8. Kandidati ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Këshillin. Pas këtij njoftimi, Këshilli vendos menjëherë përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit. Akti i Këshillit për konstatimin e tërheqjes nga kandidimi i njoftohet menjëherë kandidatit dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

C. Afatet dhe llogaritja e tyre

9. Afatet në procedurën e verifikimit të kandidatëve caktohen në ditë kalendarike.

10. Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në ligj ose në këtë Vendim, në llogaritjen e afatit përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati.

11. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.

12. Dita e fundit e afatit të kryerjes së veprimit procedural, paraqitjes së kërkesave dhe shpjegimeve, vazhdon deri në orën 24 të saj. Afati nuk quhet i humbur, kur kërkesa, shpjegimet ose akti është dërguar me postë edhe në ditën e fundit të afatit.



#### Ç. Njoftimet

13. Njoftimet e Këshillit drejtuar kandidatit gjatë procedurës së verifikimit bëhen me shkresë, në adresën postare ose në adresën elektronike të deklaruar për këtë qëllim nga kandidati, pranë Këshillit ose subjektit ku ka paraqitur kandidaturën.

14. Njoftimet dhe kërkesat e kandidatit drejtuar Këshillit bëhen me shkrim, duke i depozituar drejtpërdrejt pranë zyrës së posaçme të Këshillit në Gjykatën e Lartë ose në adresën elektronike të Këshillit, e cila i është bërë e njohur për këtë qëllim secilit kandidat, me fillimin e procedurave të verifikimit të kandidaturave.

15. Kandidati, në ditën e thirrjes nga Këshilli për t'u pajisur me formularët e deklarimit dhe të autorizimeve sipas ligjit dhe këtij vendimi, deklaron me shkrim adresën postare dhe adresën elektronike për efekt të komunikimit dhe njoftimeve me Këshillin. Njëkohësisht, për efekt të pranimin të njoftimeve që dërgon, kandidati njihet me adresat zyrtare elektronike të Këshillit.

16. Kandidati ka detyrimin të njoftojë menjëherë me shkrim Këshillin për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës postare dhe elektronike të deklaruar.

### III. Fazat e procedurës administrative të verifikimit të kandidatëve

A. Veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit

17. Procedura administrative e verifikimit të kandidatëve fillon dhe zhvillohet njëkohësisht për të gjitha kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

18. Pas caktimit me short, relatori ndjek dhe kryen të gjitha veprimet procedurale dhe verifikuese të lidhura me proceset e ndryshme të verifikimit të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore nga secili kandidat.

19. Në kryerjen e detyrës, relatori mbështetet nga këshilltarët ligjorë dhe personeli administrativ i Gjykatës së Lartë, të cilët, kanë detyrimin të ndjekin procedurat, të kryejnë veprimet dhe të përgatisin aktet përkatëse, sipas udhëzimeve të relatorit.

20. Krahas veprimeve procedurale dhe verifikuese të tjera që i vlerëson të nevojshme rast pas rasti, për secilin kandidat, relatori realizon procedurat standarde si më poshtë:

a) pajisjen e kandidatit me formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave private e kandidatit për pozicione të ndryshme në

institucionet e sistemit të drejtësisë”;

b) pajisjen e kandidatit me formularin për vetëdeklarim sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

c) pajisjen e kandidatit me formularin e aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta”, në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015;

ç) pajisjen dhe marrjen në dorëzim të nënshkruar të formularëve për dhënien e miratimit për përpunimin e të dhënave personale;

d) pajisjen dhe marrjen në dorëzim të nënshkruar të formularëve autorizues për verifikimin, në të gjitha subjektet publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të të dhënave që lidhen me kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit;

dh) pajisjen dhe marrjen në dorëzim të nënshkruar nga kandidati të formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktin telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës;

e) dërgimin e shkresave standarde për kërkimin e informacionit dhe të shpjegimeve përkatëse nga kandidati, institucionet publike dhe subjektet private, në lidhje me kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

21. Në rastin e kandidatëve që rezultojnë, njëkohësisht, të kandiduar në më shumë se një pozicion vakant në proces shqyrtimi nga Këshilli, relatorët përkatës të pozicioneve vakante, realizojnë bashkërisht procedurat standarde verifikuese të përcaktuara në pikën 20 të këtij vendimi.

22. Pas caktimit me short, relatori njofton menjëherë zyrtarisht kandidatin për fillimin e procedurave të verifikimit të kandidaturës dhe për detyrimin për t'u paraqitur, jo më vonë se 3 ditë nga ajo e njoftimit, në zyrën e posaçme të Këshillit pranë Gjykatës së Lartë, për t'u pajisur me formularët e deklarimeve dhe të autorizimeve të përcaktuara në pikën 20 të këtij vendimi. Në pamundësi objektive për t'u paraqitur brenda afatit 3-ditor, kandidati njofton menjëherë relatorin duke i parashtruar edhe motivet përkatëse. Relatori, kur motivet janë të justifikuar, i cakton kandidatit një afat të ri të arsyeshëm për t'u paraqitur pranë Këshillit.



23. Nëse nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga secili kandidat, relatori konstaton dhe vlerëson se është i paplotë, njofton menjëherë kandidatin për të përmbushur detyrimin e plotësimit të tij sipas ligjit, duke i caktuar një afat jo më shumë se 5 ditë për dorëzimin e tij pranë zyrës së posaçme të Këshillit në Gjykatën e Lartë. Kur i vlerëson të justifikuar motivet e paraqitura nga kandidati për mospërmbushjen e detyrimit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar brenda afatit 5-ditor, relatori i cakton një afat të ri të arsyeshëm.

24. Pas realizimit të procedurave të parashikuara në pikat 22 dhe 23 të këtij vendimi, relatori procedon me dërgimin e shkresave standarde për kërkimin e informacionit dhe të shpjegimeve përkatëse nga kandidati, institucionet publike dhe subjektet private, në lidhje me kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

25. Në procedurën e verifikimit, relatori shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga secili kandidat, formularët e deklarimeve të plotësuara, aktet e dërguara nga organet e ngarkuara me ligj për kontrollin dhe verifikimin e deklarimeve të kandidatëve, si edhe çdo akt, informacion dhe të dhënë tjetër të dërguar nga subjektet publike dhe private, me nismën e tyre ose mbi kërkesën e Këshillit apo që relatori vlerëson se ka lidhje me gjykimin mbi plotësimin ose jo të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore për kandidim.

26. Bazuar në gjetjet e procedurës së verifikimit, nëse vlerëson paraprakisht që mund të procedohet me urdhërimin e lejimit ose të ndalimit të kandidimit, relatori njofton kandidatin e verifikuar lidhur me gjetjet paraprake, si edhe për të drejtën që:

a) brenda një afati 5-ditor nga dita e njoftimit, të paraqesë me shkrim, drejtpërdrejt pranë zyrës së posaçme të Këshillit në Gjykatën e Lartë ose në rrugë elektronike, qëndrimin dhe shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit, si edhe të dokumentacionit mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të kandidatis;

b) të tërheqë, sipas rastit, kopje të dokumentacionit dhe të akteve të këtij procedimi administrativ ose të asaj pjesë të tyre që lidhet me verifikimin e kushteve dhe kriterëve përkatëse ligjore për të cilat relatori ka vlerësuar paraprakisht se mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

27. Në pamundësi objektive ose për motive të tjera të justifikuar për të paraqitur qëndrimin dhe shpjegimet brenda afatit 5-ditor, kandidati njofton menjëherë Këshillin, duke i parashtruar edhe motivet përkatëse. Kur i vlerëson motivet si të justifikuar, relatori i cakton kandidatis një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur qëndrimet dhe shpjegimet lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit.

28. Në rastin kur, në përfundim të afatit të njoftimeve sipas pikave 22 deri 27 të këtij vendimi, kandidati nuk paraqitet, nuk i përgjigjet njoftimeve të Këshillit, nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar ose nuk parashtron shpjegime me shkrim për gjetjet e procedurës së verifikimit, relatori procedon me përgatitjen e relacionit mbi gjendjen e faktit dhe problemet ligjore të konstatuara dhe dërgimin menjëherë të çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

29. Nëse në përfundim të këtyre procedurave administrative për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, relatori vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me përgatitjen e çështjes dhe të relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e dërgon menjëherë çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

30. Nëse vlerëson që kandidati nuk përmbush ndonjërin prej kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, relatori procedon me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe dërgimin menjëherë të çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit, pa qenë i nevojshëm kryerja e procedurës së verifikimit për të gjitha kushtet dhe kriteret e tjera ligjore.

31. Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projektaktin mbi përfundimin e procedurës administrative të verifikimit të kandidatis të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

32. Kur gjatë zhvillimit të procedurave të verifikimit, për shkak të tërheqjes nga kandidimi apo të vendimit të ndalimit nga kandidimi, relatori përkatës i pozicionit vakant konstaton se numri i kandidatëve, për atë pozicion vakant në Gjykatën Kushtetuese ose të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përkatësisht, zbret në më pak se 3 dhe 5 kandidatë, njofton menjëherë Kryetarin, i cili



thërret mbledhjen e Këshillit për të vendosur mbi mënyrën e procedimit të mëtejshëm me atë pozicion vakant.

B. Shqyrtimi dhe miratimi i projektaktit të verifikimit nga Këshilli

33. Kryetari i Këshillit, menjëherë pas njoftimit nga relatori për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Këshillit, duke i dërguar anëtarëve edhe materialet e çështjes. Mbledhja zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga ajo e njoftimit të relatorit.

34. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i njoftohet kandidatit të verifikuar dhe subjekteve që ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit sipas ligjit. Avokatit të Popullit i dërgohet edhe dokumentacioni i përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera prej tij gjatë procedurës së ndjekur për verifikimin e kandidatit. Ky njoftim bëhet publik edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

35. Në mbledhjen e Këshillit marrin pjesë anëtarët. Gjithashtu, marrin pjesë Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e subjekteve që ftohen sipas ligjit, mosparaqitja e të cilëve nuk përbën shkak për shtyrjen e mbledhjes.

36. Mbledhja e Këshillit është e vlefshme nëse marrin pjesë së paku 5 anëtarë të tij.

37. Kryetari i Këshillit fton relatorin e çështjes që të paraqesë përmbledhjen e procedurave, të fakteve dhe të gjetjeve që kanë rezultuar gjatë zhvillimit të procedurave për verifikimin e përmbushjes së kushteve dhe kritereve të tjera ligjore nga kandidati i verifikuar.

38. Në përfundim të parashtrimeve të relatorit, nëse vlerësojnë, anëtarët e Këshillit mund t'i drejtojnë pyetje dhe të kërkojnë shpjegime të natyrës sqaruese.

39. Pas anëtarëve të Këshillit, nëse e vlerëson, Avokati i Popullit mund të parashtrorë mendime dhe vlerësime vetëm në lidhje me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit.

40. Nëse anëtarët e Këshillit nuk parashtrorë pyetje dhe kërkesa të tjera sqaruese në drejtim të relatorit, Këshilli deklaron kalimin në fazën e bisedimit, votimit dhe të dhënies së vendimit.

41. Bisedimet e çështjes, si edhe votimi i vendimit bëhen vetëm me praninë e anëtarëve të Këshillit.

42. Këshilli, pasi dëgjon paraprakisht diskutimin e relatorit, bisedon dhe vendos për të gjitha çështjet që parashtrorë në relacionin e përgatitur prej tij ose që vlerësohen nga anëtarët.

43. Në përfundim të bisedimeve, për zgjidhjen e çështjes, i pari voton relatori, i pasuar nga Kryetari dhe me radhë nga anëtarët e tjerë, sipas renditjes së përbërjes së Këshillit që rezulton nga përzgjedhja me short e anëtarëve nga Presidenti apo Kuvendi.

44. Vendimet e Këshillit në lidhje me procedurën e verifikimit të kandidatëve merren me shumicën e votave të anëtarëve të Këshillit që marrin pjesë në mbledhje. Abstenimi nuk lejohet. Në rast të barazisë së votave, kandidimi konsiderohet i lejuar.

45. Vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Këshillit që kanë marrë pjesë në dhënien e tij. Anëtari, mendimi i të cilit ka mbetur në pakicë, shkruan fjalën “kundër” dhe nënshkruan vendimin.

46. Nëse për shkak të natyrës së çështjes, arsyetimi i vendimit kërkon kohë, Këshilli mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari, jo më vonë se 3 ditë nga ajo e shpalljes.

47. Përveç rastit kur ka mbetur në pakicë, arsyetimi i vendimit të Këshillit bëhet nga relatori i çështjes. Anëtari që ka mbetur në pakicë, arsyeton qëndrimin e tij, i cili i bashkohet vendimit.

48. Në rastin kur, pas shqyrtimit të relacionit dhe të akteve që përmban dosja e kandidatit të verifikuar, Këshilli vjen në përfundim që ka vend për të vlerësuar edhe mundësinë e ndalimit të kandidimit, por në atë çështje nuk janë ndjekur procedurat e përcaktuara në pikat 22 deri në 27 të këtij vendimi, shpall caktimin e një seance tjetër për shqyrtimin e çështjes. Kandidatit të verifikuar i njoftohet materiali me gjetjet dhe motivet të cilat mund të sjellin ndalimin e kandidimit. Kandidati ka të drejtën e parashtrimit me shkrim të shpjegimeve të tij dhe dokumenteve mbështetës, jo më vonë se 5 ditë nga ajo e ardhjes në dijeni të materialit të dërguar nga Këshilli.

49. Në rastet e parashikuara në pikën 32 të këtij vendimi, në përfundim të bisedimit të çështjes, Këshilli mund të vendosë pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe:

a) njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për pozicionin vakant të gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese;





b) rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për pozicionin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

50. Në rastet e tjera, pas bisedimit dhe votimit të çështjes në dhomën e këshillimit, Këshilli vendos:

a) lejimin e kandidimit;

b) ndalimin e kandidimit;

c) vijimin e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

51. Këshilli vendos ndalimin e kandidimit nëse kandidati nuk përmbush qoftë edhe njërin nga kushtet ose kriteret e tjera ligjore të kandidimit, duke u bazuar në të dhënat që përmbajnë:

a) deklaratimet dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati;

b) gjetjet dhe përfundimet e organeve kompetente të kontrollit të pasurisë dhe të integritetit të kandidatit, si edhe informacionet e subjekteve të tjera publike dhe private dërguar në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit.

52. Këshilli vendos ndalimin e kandidimit edhe në rastet kur, pas njoftimeve të Këshillit gjatë procedurës së verifikimit, kandidati përsëri nuk i përmbush detyrimet për paraqitjen ose plotësimin e deklaratave, autorizimeve dhe të dokumentacionit lidhur me kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit të parashikuara nga ligji.

C. Akti i verifikimit. E drejta e ankimit

53. Vendimi i Këshillit për procedurën e verifikimit të kandidatit është i arsyetuar dhe hartohet sipas kërkesave të nenit 99 të Kodit të Procedurave Administrative lidhur me formën dhe përmbajtjen e aktit administrativ.

54. Në zbatim të nenit 238, të ligjit nr. 115/2016, vendimi i arsyetuar i Këshillit i njoftohet kandidatit, i cili, në rastin e ndalimit të kandidimit, vetëm për pretendime për shkelje të rënda procedurale, ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ç. Publikimi i akteve të procedurës së verifikimit. Komunikata për median

55. Vendimet e Këshillit për verifikimin e kandidaturave bëhen publike në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

56. Në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi publikohen edhe:

a) lista e kandidatëve për të cilët është vendosur ndalimi i kandidimit;

b) lista e kandidatëve për të cilët është vendosur lejimi i kandidimit;

c) përmbledhje e procesverbalit të nënshkruar nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në mbledhjen ku vendoset lejimi ose ndalimi i kandidimit;

ç) komunikata për median sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 233, të ligjit nr. 115/2016.

#### IV. Procedura të veçanta për verifikimin e kandidatëve

57. Përveç kur parashikohet ndryshe në seksionet A, B dhe C të këtij kreu, për zhvillimin e procedurës së verifikimit të pasurisë, integritetit dhe të kushteve të tjera ligjore të kandidatit, zbatohen rregullat e përgjithshme të parashikuara në kreun II dhe kreun III të këtij vendimi.

A. Verifikimi i pasurisë së kandidatit

58. Jo më vonë se 3 ditë nga ajo e njoftimit zyrtar për fillimin e procedurës së verifikimit, kandidati paraqitet në zyrën e posaçme të Këshillit pranë Gjykatës së Lartë për të tërhequr, kundrejt nënshkrimit, kopjen fizike të formularit “Deklaratë e pasurisë dhe interesave private e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” të hartuar nga ILDKPI-ja në zbatim të nenit 3/1, të ligjit nr. 9049/2003, si edhe informacionin mbi lidhjen elektronike zyrtare të ILDKPI-së në të cilën kandidati mund të marrë dhe plotësojë në rrugë elektronike këtë deklaratë, përfshirë udhëzimin përkatës për mënyrën e plotësimin të saj.

59. Njëkohësisht, kandidati pajiset me formularët e autorizimeve për Këshillin që, në zbatim të pikës 4 të nenit 229, të ligjit nr. 115/2016, të kryejë verifikimin në të gjitha subjektet publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit dhe personave të lidhur. Autorizimet, të nënshkruar rregullisht, nga kandidati dhe personat e lidhur, depozitohen pranë zyrës së posaçme të Këshillit në Gjykatën e Lartë, jo më vonë se 5 ditë nga ajo e marrjes në dorëzim.

60. Jo më vonë se 5 ditë nga ajo e nënshkrimit dhe dorëzimit nga kandidatët dhe personat e lidhur të autorizimeve sipas pikës 59 të këtij vendimi:

a) Këshilli i dërgon ILDKPI-së listën e kandidatëve që i nënshtrohen procedurës së



verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas ligjit nr. 115/2016;

b) relatori fillon procedurat për kryerjen e veprimeve të kërkimit nga subjekte publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit dhe personave të lidhur.

61. Jo më vonë se 15 ditë nga marrja e formularit të deklarimit të pasurisë, kandidati e dorëzon atë të plotësuar pranë ILDKPI-së. Deklarimi bëhet sipas përcaktimeve të neneve 3/1, 4 pika 2 e vijues të ligjit nr. 9049/2003.

62. ILDKPI-ja njofton menjëherë Këshillin në rastin kur kandidati nuk e dorëzon të plotësuar formularin e deklarimit të pasurisë.

63. ILDKPI-ja kryen kontrollin e plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe interesave private të kandidatit jo më vonë se 30 ditë nga paraqitja e kësaj deklarate pranë ILDKPI-së.

64. Nëse gjatë 180 ditëve para asaj të paraqitjes së deklaratës, kandidati i është nënshtruar kontrollit të plotë nga ILDKPI-ja dhe kontrolli nuk ka rezultuar në disfavor të tij, si edhe në rastin kur ILDKPI-ja vlerëson se nuk është vendi për rikontroll të plotë sipas përcaktimit të pikës 4, të nenit 25/1, të ligjit nr. 9049/2003, atëherë kontrolli konsiderohet i kryer. ILDKPI-ja i dërgon menjëherë Këshillit kopjen e deklarimit të bërë nga kandidati, si edhe gjetjet dhe përfundimet e këtij institucioni nga procedura e mëparshme e kontrollit të plotë të deklarimit. Në çdo rast, Këshilli kryen veprimet e parashikuara nga shkronja “b”, e pikës 60, të këtij vendimi.

65. Pavarësisht parashikimit të pikës 64 të këtij vendimi, nëse pas fillimit të procedurës së verifikimit të kandidatit, relatori vjen në dijeni, nga burime të ligjshme, për rrethana që vënë në dyshim vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave që përmbahen në deklarimin e pasurisë së kandidatit, njofton menjëherë ILDKPI-në për të ushtruar kompetencën e rikontrollit të plotë të deklarimit të kandidatit sipas parashikimeve neneve 3/1 dhe 25/1 pika 4, të ligjit nr. 9049/2003.

66. Në përfundim të verifikimit të kryer sipas ligjit, ILDKPI-ja i dërgon menjëherë Këshillit raportin e kontrollit të plotë për pasuritë, interesat

private dhe detyrimet financiare të kandidatit dhe personave të lidhur.

67. Relatori shqyrton rezultatet e kontrollit, gjetjet dhe përfundimet e raportit të ILDKPI-së, si edhe të dhënat mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare të kandidatit dhe personave të lidhur, të dërguara nga subjektet publike dhe private sipas kërkesës së Këshillit.

68. Në varësi të rezultateve të kontrollit dhe nevojave të verifikimit të mëtejshëm të pasurisë, relatori mund të kërkojë:

a) informacione shtesë nga subjektet publike dhe private;

b) shpjegime me shkrim nga kandidati, i cili, jo më vonë se 5 ditë nga ardhja dijeni, duhet të paraqesë këto shpjegime dhe dokumente mbështetës drejtpërdrejt pranë zyrës së posaçme të Këshillit në Gjykatën e Lartë. Nëse për motive të justifikuar nuk mund të respektojë afatin 5-ditor, kandidati njofton menjëherë Këshillin. Kur i vlerëson motivet si të justifikuar, relatori i cakton kandidatit një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur shpjegimet lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit.

69. Në rastin kur në procedurën e verifikimit e pasurisë lind nevoja për njohuri të posaçme lidhur me konstatimin dhe sqarimin e të dhënave që rezultojnë nga deklaratimet e kandidatit, gjetjet dhe përfundimet e ILDKPI-së dhe atyre të sjella nga subjektet publike e private, relatori ka të drejtën të thërrasë ekspertë të fushës përkatëse.

70. Ekspertët përzgjidhen nga listat e përditësuara të subjekteve të licencuar për fushën përkatëse nga organi kompetent sipas ligjit ose ndërmjet atyre që e ushtrojnë veprimtarinë në institucione të specializuara.

71. Ekspertët caktohen nga Këshilli, mbi propozimet e parashtruara nga anëtari relator i pozicionit vakant. Shpenzimet e ekspertit përballohen nga buxheti i Gjykatës së Lartë.

72. Kandidati që verifikohet njoftohet menjëherë për ekspertin e caktuar nga Këshilli. Jo më vonë se 5 ditë nga ardhja dijeni, kandidati njofton Këshillin, duke parashtruar me shkrim edhe motivet konkrete përkatëse, nëse pretendon gjendjen e papajtueshmërisë apo të konfliktit të interesit me ekspertin. Lidhur me pretendimet e kandidatit, Këshilli disponon sipas ligjit.

73. Përpara fillimit të detyrës, eksperti nënshkruan formulën e betimit. Pas veprimit të



betimit, sipas udhëzimeve të relatorit, ekspertit ka detyrimin të shqyrtojë aktet, të përgatisë, sipas rastit, raport financiar apo mendimin e tij me shkrim, si edhe të ruajë konfidencialitetin e të dhënave që siguron gjatë kryerjes së ekspertimit.

74. Kur e vlerëson, Këshilli mund të thërrasë ekspertin për të dhënë shpjegime në mbledhjen e Këshillit. Në vendimin e arsyetuar të Këshillit për lejimin ose ndalimin e kandidimit trajtohet edhe nevoja për ekspertim dhe mendimi i dhënë nga ekspertit.

75. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të ILDKPI-së, atyre të nxjerra nga të dhënat që rezultojnë nga shkresat e dërguara nga subjektet publike dhe private, si edhe nga shpjegimet me shkrim të dhëna nga kandidati, relatori vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me përgatitjen e pjesës së relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të pasurisë.

76. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të ILDKPI-së, atyre të nxjerra nga të dhënat që rezultojnë nga shkresat e dërguara nga subjektet publike dhe private, si edhe nga shpjegimet me shkrim të dhëna nga kandidati, relatori vlerëson se ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me përgatitjen e relacionit mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të pasurisë dhe e dërgon menjëherë çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

77. Ndalimi i kandidimit vendoset në rastet kur ka të dhëna nga burime të ligjshme se kandidati:

a) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;

b) ka fshehur pasurinë dhe të dhënat mbi interesat private, që janë të detyrueshme të deklarohen;

c) ka kryer deklaram të rremë;

ç) gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

78. Ndalimi i kandidimit vendoset edhe në rastet kur kandidati:

a) ka refuzuar të përmbushë detyrimin për t'u pajisur me formularin e deklaratës së pasurisë ose nuk e ka plotësuar dhe depozituar atë pranë ILDKPI-së sipas ligjit;

b) ka refuzuar nënshkrimin e autorizimeve të kërkuara nga Këshilli për verifikimin e pasurisë.

B. Verifikimi i integritetit të kandidatit

79. Jo më vonë se 3 ditë nga ajo e njoftimit zyrtar për fillimin e procedurës së verifikimit, kandidati paraqitet në zyrën e posaçme të Këshillit pranë Gjykatës së Lartë për të tërhequr, kundrejt nënshkrimit:

a) kopjen fizike të formularit për vetëdeklarim sipas ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

b) kopjen fizike të formularit të aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta”, sipas ligjit nr. 45/2015;

c) informacionin mbi lidhjen elektronike në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë pjesa e caktuar për Këshillin, në të cilën kandidati mund të marrë dhe plotësojë sipas ligjit, në rrugë elektronike, këto formularë deklarimi;

ç) formularin e autorizimit për Këshillin që, në zbatim të pikës 4, të nenit 229, të ligjit nr. 115/2016, të kryejë verifikimin pranë organeve kompetente sipas ligjit, të të dhënave mbi figurën dhe integritetin e kandidatit.

80. Jo më vonë se 5 ditë nga marrja e formularëve të parashikuar në pikën 79 të këtij vendimi, kandidati i dorëzon ato të plotësuar në zyrën e posaçme të Këshillit pranë Gjykatës së Lartë.

81. Vetëdeklarimi i kandidatit sipas ligjit nr. 138/2015 bëhet publik në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

82. Kryetari i Këshillit e përcjell menjëherë formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015, të plotësuar nga kandidati, në Prokurorinë e Përgjithshme.

83. Prokuroria e Përgjithshme kryen verifikimet sipas ligjit jo më vonë se 30 ditë nga paraqitja e vetëdeklarimit pranë atij institucioni.

84. Gjithashtu, jo më vonë se 5 ditë nga dorëzimi i vetëdeklarimit të kandidatit, të plotësuar sipas ligjit nr. 138/2015, në zyrën e posaçme të Këshillit pranë Gjykatës së Lartë, relatori kryen edhe veprimet për kërkimin e informacionit mbi pengesat ligjore sipas shkronjave “a” dhe “c”, të pikës 89 të këtij vendimi, nga Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar.

85. Formulari i aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta” sipas nenit 29, të ligjit nr. 45/2015, i plotësuar nga kandidati, i dërgohet menjëherë për kompetencë dhe shqyrtim



Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

86. Në varësi të rezultateve të kontrollit dhe nevojave të verifikimit të mëtejshëm të integritetit të kandidatit, relatori mund të kërkojë:

a) informacione shtesë nga institucionet e përmendura në këtë seksion;

b) shpjegime me shkrim nga kandidati, i cili, jo më vonë se 5 ditë nga ardhja dijani, duhet të paraqesë drejtpërdrejt pranë zyrës së posaçme të Këshillit në Gjykatën e Lartë, shpjegimet e tij dhe dokumentet mbështetës. Nëse për motive të justifikuar nuk mund të respektojë afatin 5-ditor, kandidati njofton menjëherë Këshillin. Kur i vlerëson motivet si të justifikuar, relatori i cakton kandidatit një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur shpjegimet lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit.

87. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të Prokurorisë së Përgjithshme, si edhe gjetjet e përfundimet e nxjerra nga të dhënat e dërguara nga institucionet e tjera të përmendura në këtë seksion, relatori vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me përgatitjen e pjesës së relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të integritetit të kandidatit.

88. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të Prokurorisë së Përgjithshme, si edhe të atyre të dërguara nga institucionet e tjera të përmendura në këtë seksion, relatori vlerëson se ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me përgatitjen e relacionit mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të integritetit dhe e dërgon menjëherë çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

89. Ndalimi i kandidimit vendoset në rastet kur nga Prokuroria e Përgjithshme dhe institucionet e tjera të përmendura në këtë seksion, konfirmohet se kandidati:

a) ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar;

b) ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

c) është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës.

90. Ndalimi i kandidimit vendoset edhe kur:

a) kandidati ka refuzuar të përmbushë detyrimin për t’u pajisur me formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 ose me formularin e aplikimit “Për informim përpara emërimit /zgjedhjes në poste të larta” sipas ligjit nr. 45/2015 apo nuk i ka plotësuar dhe depozituar ato;

b) kandidati ka refuzuar nënshkrimin e autorizimit për Këshillin që, në zbatim të pikës 4 të nenit 229 dhe pikës 2, të nenit 237, të ligjit nr. 115/2016, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, lidhur me të dhënat që lidhen integritetin e kandidatit.

C. Verifikimi i kushteve të tjera ligjore të kandidimit

91. Jo më vonë se 3 ditë nga ajo e njoftimit zyrtar për fillimin e procedurës së verifikimit, kandidati pajiset me formularin e autorizimit për Këshillin që, në zbatim të pikës 4, të nenit 229 dhe pikës 2, të nenit 237, të ligjit nr. 115/2016, të kryejë verifikimin në të gjitha subjektet publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, lidhur me të dhënat që lidhen me plotësimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, të përcaktuara në nenin 7/a, të ligjit nr. 8577/2000, për kandidimet në Gjykatën Kushtetuese dhe në nenin 199, të ligjit nr. 115/2016 për kandidimet për inspektorë të lartë të drejtësisë. Autorizimi, i nënshkruar rregullisht nga kandidati, depozitohet pranë zyrës së posaçme të Këshillit në Gjykatën e Lartë, jo më vonë se 5 ditë nga ajo e marrjes në dorëzim.

92. Relatori shqyrtton dokumentacionin e paraqitur nga kandidati për të vlerësuar nëse, për efekt të verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, të dhënat e deklaruara janë të plota, kanë përmbajtje të saktë dhe nuk gjenden elementë që sjellin dyshime për vërtetësinë e dokumentit apo të përmbajtjes së tij.

93. Kur nga shqyrtimi i dokumentacionit vlerëson se të dhënat e deklaruara nuk janë të plota, përmbajnë pasaktësi ose edhe elementë që sjellin dyshime për vërtetësinë e dokumentit apo të përmbajtjes së tij, relatori mund të kërkojë:

a) informacione nga subjektet publike dhe private;

b) shpjegime me shkrim nga kandidati, i cili, jo më vonë se 5 ditë nga ardhja dijani, duhet të paraqesë drejtpërdrejt pranë zyrës së posaçme të Këshillit në Gjykatën e Lartë, shpjegimet e tij dhe



dokumentet mbështetës. Nëse për motive të justifikuar nuk mund të respektojë afatin 5-ditor, kandidati njofton menjëherë Këshillin. Kur i vlerëson motivet si të justifikuar, relatori i cakton kandidatin një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur shpjegimet lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit.

94. Nëse nga gjetjet e procesit të verifikimit, relatori vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me përgatitjen e pjesës së relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit.

95. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e nxjerra nga dokumentacioni i paraqitur nga kandidati, si edhe nga gjetjet e përfundimet e nxjerra nga shqyrtimi i shkresave të dërguara nga subjektet publike dhe private, relatori vlerëson se ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me përgatitjen relacionit mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore dhe e dërgon menjëherë çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

96. Ndalimi i kandidimit vendoset në rastet kur nga dokumentacioni i paraqitur nga kandidati, si edhe nga shkresat e dërguara nga subjektet publike dhe private, rezulton se kandidati nuk plotëson ndonjërin prej kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të parashikuara, përkatësisht, nga neni 7/a i ligjit nr. 8577/2000 për kandidimet në Gjykatën Kushtetuese dhe nga neni 199, të ligjit nr. 115/2016, për kandidimet për inspektorë të lartë të drejtësisë.

97. Ndalimi i kandidimit vendoset edhe kur kandidati ka refuzuar nënshkrimin e autorizimit për Këshillin që, në zbatim të pikës 4, të nenit 229 dhe pikës 2, të nenit 237, të ligjit nr. 115/2016, të kryejë verifikimin në të gjitha subjektet publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, lidhur me të dhënat që lidhen me plotësimin e kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit.

#### **V. Dispozita kalimtare dhe të fundit**

A. Fillimi i procedurës së verifikimit të kandidatëve në pozicionet vakante të shpallura dhe të depozituara pranë Këshillit

98. Procedurat e verifikimit të pasurisë, integritetit, si edhe të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidatëve, për pozicionet vakante të

shpallura për Gjykatën Kushtetuese dhe, për të cilat, subjektet që vënë në lëvizje Këshillin, kanë depozituar pranë Këshillit dokumentacionin përkatës sipas ligjit, fillojnë jo më vonë se 5 ditë nga ajo e hyrjes në fuqi të aktit nënligjor normativ të nxjerrë nga Këshilli mbi rregullat më të detajuara për vlerësimin, pikëzimin, përzgjedhjen dhe renditjen e kandidatëve në zbatim të pikës 2, të nenit 229, të ligjit nr. 115/2016.

99. Njoftimi zyrtar i Këshillit për fillimin e procedurave ligjore të verifikimit të kandidaturave sipas ligjit nr. 115/2016 shpallet menjëherë në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, si edhe bëhet e njohur nëpërmjet komunikatës së posaçme për mediat.

100. Gjithashtu, ky njoftim zyrtar, i dërgohet individualisht secilit kandidat në adresën elektronike të deklaruar prej tij në dokumentacionin e kandidimit të depozituar pranë Këshillit.

B. Verifikimi i kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidatëve jomagjistratë

101. Afati 180-ditor i përcaktuar nga pika 2 e nenit 3/1, të ligjit nr. 9049/2003, lidhur me procedurën e verifikimit dhe të kontrollit të plotë të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, llogaritet nga dita e dorëzimit të plotësuar të deklaratës së pasurisë dhe interesave private të kandidatin pranë ILDKPI-së.

102. Pavarësisht se në kohën e kandidimit, i ka depozituar të plotësuar pranë subjekteve që vënë në lëvizje Këshillin, jo më vonë se 5 ditë nga marrja e formularëve të parashikuar në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 79 të këtij vendimi, kandidati duhet t'i plotësojë me të dhëna të aktualizuara dhe t'i dorëzojë ato në zyrën e posaçme të Këshillit pranë Gjykatës së Lartë.

103. Jo më vonë se 15 ditë nga ajo e depozitimit të autorizimit për Këshillin sipas pikës 91 të këtij vendimi, kandidatët duhet të depozitojnë pranë Këshillit deklarime dhe aktet zyrtare përkatëse të reja, me të dhëna të aktualizuara, të lëshuara nga autoritetet kompetente, lidhur përmbushjen e kushteve të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të parashikuara, përkatësisht, në shkronjat “c”, “ç” dhe “d”, të nenit 7/a, të ligjit nr. 8577/2000 dhe në shkronjat “ç”, “d” dhe “dh”, të nenit 199, të ligjit nr. 115/2016.



C. Verifikimi i kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore së kandidatëve magjistratë

104. Kandidatët magjistratë dhe subjektet e tjerë që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, për të cilët nuk është dhënë vendim nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të integritetit nga Këshilli. Vendimi i Këshillit, për urdhërimin e lejimit ose të ndalimit të kandidimit sipas neneve 235 dhe 236, të ligjit nr. 115/2016 për këta kandidatë, do të mbështetet në vendimin e dhënë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

105. Kandidatët magjistratë dhe subjektet e tjerë që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, të cilët janë konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të integritetit, të parashikuar nga nenet 235 dhe 236, të ligjit nr. 115/2016.

106. Jo më vonë se 15 ditë nga ajo e depozitimit të autorizimit për Këshillin sipas pikës 91 të këtij vendimi, të gjithë kandidatët e treguar në pikat 104 dhe 105 të këtij vendimi, duhet të depozitojnë pranë Këshillit deklarime dhe aktet zyrtare përkatëse të reja, me të dhëna të aktualizuara, të lëshuara nga autoritetet kompetente, lidhur përmbushjen e kushteve të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të parashikuara, përkatësisht, në shkronjat “c”, “ç” dhe “d” të nenit 7/a, të ligjit nr. 8577/2000 dhe në shkronjat “ç”, “d” dhe “dh” të nenit 199, të ligjit nr. 115/2016.

107. Pavarësisht nga parashikimet e pikave 104 dhe 105 të këtij vendimi, të gjithë këta kandidatë magjistratë dhe subjekte të tjerë që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, i nënshtrohen menjëherë procedurave të verifikimit të integritetit sipas ligjit nr. 45/2015.

108. Procedura e përcaktuar sipas nenit 236, të ligjit nr. 115/2016, për verifikimin e integritetit të kandidatëve magjistratë dhe subjekteve të tjerë që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, shtrihet për periudhën pas asaj të datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar për konfirmimin e tyre në detyrë.

109. Afati 180-ditor i përcaktuar nga pika 2 e nenit 3/1, të ligjit nr. 9049/2003, lidhur me

kryerjen e procedurës së verifikimit dhe kontrollit të plotë të pasurisë së kandidatëve magjistratë dhe subjekteve të tjerë që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, llogaritet nga dita e dorëzimit të plotësuar të deklaratës së pasurisë dhe interesave private të kandidatit pranë ILDKPI-së.

110. Nëse procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidatëve magjistratë dhe subjekteve të tjerë që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, fillojnë pas afatit 180-ditor të përcaktuar nga pika 2 e nenit 3/1, të ligjit nr. 9049/2003, procedura e verifikimit të pasurisë së këtyre kandidatëve shtrihet mbi interesat pasurore, private dhe konfliktin e interesit, për periudhën pas asaj të datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar për konfirmimin e tyre në detyrë.

111. Kandidatët magjistratë dhe subjektet e tjerë që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, të cilët nuk janë konfirmuar në detyrë me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, edhe kur ndaj atij vendimi është paraqitur ankim, nuk lejohen të kandidojnë dhe nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas neneve 235, 236 dhe 237, të ligjit nr. 115/2016.

Ç. Rregulla kalimtare për përmbylljen e procedurave të verifikimit

112. Procedurat e verifikimit të kandidaturave për pozicionet vakante nuk mund të përfundojnë përpara se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit të ketë dhënë vendim lidhur me kandidatët magjistratë dhe subjekte të tjerë sipas procedurës së rivlerësimit kalimtar në zbatim të ligjit nr. 84/2016.

113. Procedurat e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave fillojnë pasi Këshilli të ketë përfunduar procedurat e verifikimit dhe të ketë vendosur për lejimin ose ndalimin e kandidimit të të gjithë kandidatëve jomagjistratë, si edhe të kandidatëve magjistratë e subjekte të tjerë që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016.

114. Për pozicionet vakante të përkohshme të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe të shpallura për aplikim nga organet e emërtesës, kërkesat për kandidim të të cilave janë administruar nga Këshilli përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi ndiqen të



njëjtat procedura të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, përveç rastit kur afati i ushtrimit të detyrës për këto pozicione vakante të përkohshme përfundon ndërkohë që Këshilli ende nuk ka përfunduar me vendim këto procedura. Në këtë rast Këshilli, kryesisht apo me njoftimin e organit të emërtesës, konstaton faktin e përfundimit të afatit kur ky mandat mund të ushtrohej dhe deklaron me vendim mbylljen e procedurave, duke njoftuar njëkohësisht organin përkatës të emërtesës dhe personat që kanë kandiduar për plotësimin e atij pozicioni vakant të përkohshëm.

D. Dispozita të fundit

115. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Ardian Dvorani**

## VENDIM

*(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 2174, datë 28.2.2019, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Ermal Xhelo, i datëlindjes 14.6.1976, vdekur në datën 13.12.2013.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 280 lekë